



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 133 Akti

Nr. 169 Vendimi
Tiranë, më 26.06.2019

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Genta Tafa (Bungo)	kryesuese
Valbona Sanxhaktari	anëtare
Lulzim Hamitaj	relator

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Anisa Duka, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Marie Tuma, në datën 24.6.2019, ora 9:30, në Pallatin e Koncerteve (ish-pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (underground), Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Regleta L. Panajoti**, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila kërkoi konfirmimin në detyrë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE : **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar” (në vijim, Kushtetuta);

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim, Ligji nr. 84/2016);

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi gjetjet dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, z. Lulzim Hamitaj, mori në shqyrtim dhe analizoi shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen, duke u bazuar në të tria kriteret e vlerësimit, atë pasuror, të figurës dhe vlerësimin profesional, mbështetur në pikat 1 dhe 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Regleta Panajoti, ushtron detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.

2. Në referim të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit ndaj subjektit të rivlerësimit ka filluar menjëherë, pasi është caktuar me short trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si dhe është shortuar shpërndarja e çështjes konkrete, në datën 15.5.2018.

3. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 24.5.2018 u caktua me mirëkuptim kryesuesi, komisionere Genta Tafa (Bungo), dhe u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit.

4. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43, të ligjit nr. 84/2016, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK); dhe Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (në vijim IKD).

4.1 Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

4.2 Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm.

5. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, në datën 31.5.2019, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, si dhe njoftimin e këtij subjekti për t'u njohur me rezultatet e hetimit administrativ, materialet e dosjes dhe dokumentet e administruara nga Komisioni gjatë hetimit, në përputhje me nenet 35-40 dhe 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative.

6. Subjekti i rivlerësimit u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja, lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni në datën 6.6.2019. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes dhe ushtri të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja në datën 17.6.2019.

7. Pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

II. SEANCA DËGJIMORE

8. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht në datën 20.6.2019.

8.1 Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, në datën 24.6.2019, ora 9:30, në Pallatin e Koncerteve, salla B, kati 0, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Marie Tuma.

8.2 Në këtë seancë subjekti i rivlerësimit u paraqit dhe u mbrojt personalisht, ajo dha shpjegime lidhur me rezultatet e hetimit, si dhe procesin e rivlerësimit të kryer.

8.3 Në përfundim, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin e tij në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

9. Znj. Regleta Panajoti ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit ndaj tij, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48, të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ. Ajo ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë

prova dhe shpjegime kur janë nevojitur. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

10. Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Për subjektin e rivlerësimit, znj. Regleta Panajoti, procesi i rivlerësimit u mbështet në të tria kriteret, atë të pasurisë, të figurës dhe vlerësimit profesional.

A. VLERËSIMI I PASURISË

11. **Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit** ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me shkresën nr. *** prot., datë 8.1.2018, në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 84/2016; në përfundim të të cilit ka konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë dhe në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

12. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a. provat e dorëzuara nga vetë subjekti në ILDKPKI në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”;
- b. raportin e dorëzuar në Komisionin nga ILDKPKI-ja;
- c. provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- d. deklaramet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- e. shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, datë 20.6.2018;
- f. deklaramet e personave të tjerë të lidhur.

13. Në deklaratën e pasurisë “Vetting”, të dorëzuar në ILDKPKI në datën 25.1.2017, **subjekti deklaroi këto pasuri** (të paluajtshme dhe të luajtshme) në emër të tij:

14. **Apartament banimi**, me sip. 104.23 m², “***”, Tiranë, blerë me kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.1.2002, në vlerën 47.150 USD, e regjistruar në bashkëpronësi midis subjektit dhe bashkëshortit të saj me certifikatë pronësie në datën 7.3.2014.

14.1 Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se kjo pasuri është deklaruar nga subjekti si më poshtë:

- i. Në deklaratën “Vetting” si apartament banimi me sip. 104.23 m², Tiranë, në shumën 47.150 USD, me burim krijimi: të ardhura nga emigracioni ekonomik dhe punësimi në Greqi; aktiviteti tregtar i bashkëshortit; të ardhura nga shpronësimi për interes publik; dhe punësimi i bashkëshortëve.
- ii. Në deklaratën e pasurisë për vitin **2003** si shtëpi banimi, me sip. 115 m², në shumën 5 milionë lekë, me burim krijimi: punë në emigracion; shitje pjese të pasurisë trashëgimore (truall në Korçë 814 m², pjesë të pasurisë së shitur nga ish-kantina e verës në Korçë, pasuri e nënës).
- iii. Në deklaratën e pasurisë për vitin **2006** dhe **2007**, adresa e këtij apartamenti është deklaruar si adresë e regjistruar në Gjendjen Civile.
- iv. Në deklaratën e pasurisë për vitin **2008** si adresë e plotë, që i përket kësaj pasurie, është deklaruar si vendbanim i subjektit.

14.2 Sipas akteve të administruara nga ZVRPP-ja Tiranë, rezulton se kjo pasuri është blerë me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.1.2002, në shumën 47.150 USD, me sip. 115.32 m².

Komisioni ka konstatuar se deklarimi i vitit 2003 nuk përputhet me deklarin "Vetting" dhe me përmbajtjen e kontratës së shitblerjes, për sa i përket shumës së shpenzuar për blerjen e kësaj pasurie. Për këtë, subjektit iu kalua barra e provës, në përputhje me nenin 52, të ligjit nr. 84/2016.

Në shpjegimet e tij, në përgjigje të barrës së provës, subjekti ka sqaruar se pagesat e blerjes së këtij apartamenti janë bërë pranë arkës së shoqërisë ndërtuese "****" sh.p.k., kundrejt lëshimit të mandatarkëtimit. Për të vërtetuar këtë, subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit tre mandatarkëtimit: (1) mandatarkëtimi me vlerë 25.000 USD (njëzet e pesë mijë), datë 29.10.2001; (2) mandatarkëtimi me vlerë 16.292 USD (gjashtëmbëdhjetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e dy), datë 4.1.2002; (3) mandatarkëtimi me vlerë 5.000 USD (pesë mijë), datë 14.1.2002 – urdhër derdhje të "taksës për hipotekë", me nr. ***, datë 15.1.2002, nga Banka e Kursimeve.

Konstatohet se e gjithë pagesa është bërë përpara deklarin për herë të parë në vitin 2003. Pagesa e kësaj të fundit të çmimit është bërë në datën 14.1.2002 dhe është deklaruar për herë të parë në deklaratën e pasurisë në vitin 2003.

Në shpjegimet e saj, subjekti ka sqaruar se deklarimi i kësaj vlere në monedhën vendase ka qenë deklarim i përafërt dhe këtë deklarim në ILDKPKI e ka mbështetur me kopje të kontratës me çmimin e konfirmuar në të prej 47.150 USD.

Arsyetimi ligjor

Pas shqyrtimit të provave të depozituara nga subjekti, si dhe shpjegimeve të paraqitura, Komisioni vlerëson se subjekti ka qenë i saktë në plotësimin e deklarin "Vetting" dhe se ky deklarim përputhet me provat shkresore të administruara.

Në lidhje me këtë, Komisioni arsyeton se pika 2, e nenit D, të Aneksit të Kushtetutës ka përcaktuar detyrimin e subjektit të dorëzojë/plotësojë një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë. Sipas Kushtetutës, dokumenti ligjor, në cilin bazohet hetimi dhe objekti i rivlerësimit kalimtar është pikërisht kjo deklaratë. Deklarimet e mëparshme të saj mund të shërbejnë si provë për Komisionin në proces, por nuk mund të përbëjnë shkak për shkarkimin e subjektit.

Konkluzioni përfundimtar i Komisionit duhet të nxirret nga qëllimi, dashja, motivi dhe sjellja e subjektit, nga mënyra e plotësimit të deklarin "Vetting" dhe nga të dhënat e hedhura në të. Përdorimi i deklarimeve ndër vite shërben për të analizuar vlerën e deklarin "Vetting", në raport me provat e tjera, me qëllim përcaktimin e burimit të ligjshëm të krijimit të pasurisë.

Komisioni vlerëson se deklarimi në lekë i vlerës së apartamentit në deklaratën e vitit 2003, në ndryshim nga deklarimi në monedhën e huaj i vlerës së apartamentit në deklaratën "Vetting, nuk përbën pasaktësi në kuptim të ligjit për rivlerësimin kalimtar, për faktin se vlera e apartamentit në vitin 2003 është deklaruar e përafërt. Në rastin konkret mungon qëllimi dhe dashja për të bërë deklarim të pasaktë, fshehje, apo deklarim të rremë nga subjekti i rivlerësimit, për sa kohë që vlera e paguar provohet me anë të dokumenteve ligjorë justifikuese, të cilat kanë një vlerë të lartë provueshmërie dhe besueshmërie dhe nuk kanë ndryshuar ndonjëherë. I gjithë dokumentacioni i administruar gjatë hetimit të çon në konkluzionin se deklarimet e subjektit në deklaratën "Vetting" janë të sakta dhe përputhen me dokumentacionin provues ligjor.

Subjekti i rivlerësimit në deklaratën "Vetting" ka deklaruar vlerën në dollarë, e përcaktuar shprehimisht në kontratë, duke plotësuar kështu kërkesën e parashikuar nga ligji nr. 84/2016 dhe neni D i Aneksit të Kushtetutës. Subjekti ka dhënë shpjegime të cilat përputhen me të gjitha rrethanat e fakti dhe provat, duke vërtetuar në mënyrë të qartë marrëdhënien juridike, vlerën e çmimit të paguar. Nga të dhënat e hetimit nuk ekziston asnjë dyshim lidhur me saktësinë e deklarin dhe qëllimin e subjektit për të bërë deklarim të pasaktë apo të pamjaftueshëm në kuptimin dhe nivelin që kërkon Aneksi i Kushtetutës dhe ligji nr. 84/2016.

Në përfundim, Komisioni i konsideron shpjegimet dhe provat e subjektit bindëse dhe në përputhje me dokumentacionin e mbledhur gjatë hetimit.

14.3 Sipas deklarin "Vetting" burimet e të ardhurave për blerjen e këtij apartamenti janë: (i) të ardhura nga emigracioni ekonomik dhe punësimi në Greqi; (ii) aktiviteti tregtar; (iii) shpronësimi

për interes publik; dhe (iv) nga punësimi i bashkëshortëve. Komisioni hetoi gjerësisht lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave.

i. Në lidhje me të ardhurat nga emigracioni ekonomik dhe punësimi në Greqi

Në deklaratën “Vetting”, subjekti ka deklaruar të ardhura të përfuara nga emigracioni sezonal në periudhën 1991 – 2004 dhe emigracioni i plotë në vitet 1995 – 1996 në Greqi, duke cilësuar faktin e lëvizjes së lirë me dokumentacion të rregullt ligjor. Shuma e të ardhurave nga emigracioni të pretenduara nga subjekti, si dhe të deklaruara nga ajo në deklarin periodik dhe deklarimin “Vetting” është rreth 3.500.000 lekë, të sjella periodikisht në *cash* nga Greqia dhe të konvertuara nga *dhrahmi* në lekë.

Subjekti ka depozituar në cilësinë e provës fotokopje të pasaportës së Republikës së Shqipërisë të personit të lidhur, bashkëshortit, z. S. P., me datë lëshimi 14.6.1995, me vizë greke të lëshuar në datën 22.1.1997 – 14.6.2000, si dhe fotokopje të pasaportës së Republikës së Shqipërisë së subjektit të rivlerësimit, me viza greke të lëshuara në datat 17.7.1997 – 16.10.97, 4.3.1998 – 3.3.1999, 23.3.1991 – 22.9.2000, etj.

Subjekti nuk ka vënë në dispozicion dokumente lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit të të ardhurave nga emigracioni ekonomik në shtetin grek.

Gjatë hetimit administrativ subjekti ka sqaruar¹ se: “... *punësimi jonë periodik në emigracion ka qenë në vitet 1991 – 1994 ku unë kam punuar në punë sezonale 3-4 muaj çdo vit në verë në Greqi dhe bashkëshorti im pas vitit 1990 ka punuar gjatë gjithë kësaj periudhe në Greqi, duke u shkëputur edhe pa të drejtë page etj.*”

Gjithashtu, subjekti ka vënë në dispozicion *statement* bankare të “NBG”, sot “ABI Bank” sh.a., ku rezulton se në janar të vitit 1998, është çelur një llogari në “NBG” në shumën 160.000 lekë. Në këtë llogari janë depozituar periodikisht shuma parash nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit. Në shtator të vitit 2001 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 5.700.000 lekë, shumë e cila është tërhequr në datën 5.9.2001. Katër ditë pas tërheqjes së kësaj shume në datën 25.9.2001, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka çelur një llogari depozite në shumën 40.000 USD. Nga nxjerrja e llogarisë rezulton se në dhjetor të vitit 2001 është tërhequr plotësisht shuma prej 40.000 USD.

Të dhënat e mësipërme përputhen me dokumentacionin bankar të sjellë në Komision nga “NBG”-ja² gjatë hetimit administrativ.

Sipas dokumentit të udhëtimit³ të të dy bashkëshortëve rezultojnë me hyrje-dalje në shtetin grek në afate tepër të shkurtra, që fillojnë nga dy ditë, një javë, apo dy javë, përkatësisht, udhëtime të kryera nga bashkëshorti i subjektit në vitin 1999 dhe nga subjekti i rivlerësimit në vitet 1996, 1997, 2000 dhe 2002 (gjithnjë brenda mundësive sa mund të vërehen hyrje-daljet në fletët e kopjeve të pasaportave të depozituara).

Në përfundim të hetimit, Komisioni vlerësoi se shpjegimet e subjektit dhe dokumentacioni i dorëzuar gjatë hetimit administrativ nuk ishte i mjaftueshëm, dhe i kaloi atij barrën e provës për të provuar me dokumentacion provues, burimin e ligjshëm të shumës prej 3.500.000 lekësh të deklaruar si të ardhura nga emigracioni, e cila ka shërbyer edhe si burim për blerjen e pasurisë **apartament banimi**, me sip. 104.23 m², “***”, Tiranë, në vitin 2002.

Në përgjigje të barrës së provës, subjekti ka sqaruar se:

“Bashkëshorti ka qenë pjesë e minoritetit grek në Shqipëri, dhe ka punuar në Greqi deri në 16 orë në ditë, në punë të ndryshme, mundësi që ia jepte mosha, gjuha, kombësia, arsimimi i tij, dhe shumë kritere të tjera të sqaruar edhe në pyetësorët 1- 4 gjatë hetimit. Pasaportat e depozituara bashkëlidhur formularit “Vetting” nuk janë të vetmet dokumente që shtetasit shqiptarë, dhe veçanërisht ata me kombësi greke, dispononin në këto vite. Por bëhet fjalë për vitet 1991 – 1995

¹ Shihni përgjigjen e pyetjes 3 në pyetësorin nr. 2, datë 6.11.2018, në dosjen e Komisionit.

² Referuar shkresës nr. ***, datë 10.7.2018, të “NBG”-së, në dosjen e Komisionit.

³ Sipas aneksit *** në dosjen e ILDKPKI-së (fletë nga pasaporta e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit).

kur shtetasit grekë, pjesë e minoritetit, kanë qenë pajisur edhe me dokumente të emërtuara “karta” të ndryshme lëvizjeje.

Ne nuk mund të disponojmë dokumentacion të këtyre viteve të llojit pasaportë shqiptare, në kushtet kur sipas ligjit të kohës, me daljen e pasaportave të reja, të vjetrat dorëzoheshin.

Po kështu, nuk mund të disponojmë kartat e vjetra të lëvizjes (dokumente të kohës të lëshuara edhe nga shteti grek) në kushtet kur ato rinovoheshin periodikisht dhe të vjetrat dorëzoheshin.

Po kështu, në momentin final të marrjes së shtetësisë greke, këto akte janë asgjësuar për shkak të kalimit të afateve të ruajtjes së tyre dhe mbajtjes pa efekt në kushtet e fitimit të të drejtave kushtetuese të shtetësisë së atij vendi.

Qëllimi i depozitimit të këtyre akteve që ne dispononim ka qenë të provuarit e mundësisë ligjore të lëvizjes sonë të lirë në Greqi në këto vite, pa asnjë pengesë të natyrës administrative apo penale. (Mbani ju lutem në konsideratë se në këtë periudhë 1990 – 1995 kanë qenë tërësisht të pakontrolluara lëvizjet migratore të shtetasve shqiptare drejt shtetit grek, e jo vetëm, ndërkohë që mundësia e lëvizjes së shtetasve minoritarë ka qenë e siguar). Asnjë përlllogaritje ditë qëndrimi apo periudhë kohore qëndrimi në Greqi (çka është konstatuar edhe prej jush kur shpreheni gjithnjë brenda mundësive sa mund të vërehen hyrje-daljet në fletët e kopjeve të pasaportave të depozituara) nuk mund të bëhet mbi këto dokumente në kushtet e pamundësisë së disponimit dhe relativitetit të të gjitha shënimeve që pikat e kalimit të kufirit vinin në dokumentet e identifikimit të shtetasve shqiptare të kohës.”

Në mbështetje të shpjegimeve të paraqitura, subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit:

a. Certifikatë e regjistrimit të një personi të siguar drejtpërdrejtë, të lëshuar nga institucioni përgjegjës për punësimin në Greqi, nga i cili rezulton se z. S. P., është deklaruar si i punësuar që në datën 16.10.1995, dhe po kështu njoftohen punëdhënësit e tij për të dhënat e personit të siguar si dhe detyrimin për ta siguar z. S. P.

b. Në seancë, subjekti ka depozituar “Libër shëndeti fëmije” për djalin e saj, O. P., i datëlindjes 10.6.1995, lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë në Greqi. Nga përmbajtja e përkthyer rezulton se vendbanimi i subjektit dhe familjes së saj në vitin 1995 është Veria, Greqi.

Më tej, subjekti ka argumentuar përpara Komisionit se: “Vetë legjislacioni grek për emigrantët nuk ka rregulluar statusin e tyre deri në vitet 2001 – 2002”. Për të provuar këtë deklaram të saj subjekti ka kërkuar të mbahen në konsideratë faktet e listuara në materialin e prezantuar përpara Forumit për Popullsinë Evropiane, me temë “Immigration into Greece 1990 – 2003” kopje të së cilës e ka depozituar në versionin anglisht, ku nënvizon se:

- a. Deri në vitin 1991 në Greqi nuk kishte asnjë ligj që rregullonte situatën e emigrantëve (f. 3).
- b. Në vitin 1991 del për herë të parë një ligj i cili i përgjigjet gjendjes së kriminalitetit në Greqi (f. 3).
- c. Në vitin 1998 dalin ligjet e para që rregullojnë *White Card* dhe *Green Card* për shqiptarët (f. 4).
- d. Në vitin 2001 del për herë të parë ligji që rregullon *Work Permit* për emigrantët (f. 6).
- e. Në vitin 2003 emigrantët filluan të aplikojnë për *work permit* (f. 7).
- f. Nga analiza e bërë nga të dhënat mbi kontributet sociale rezulton se Greqia ka qenë në pamundësi për të siguar *work permit* edhe për vetë grekët (që në atë kohë përkthehej në mungesë të kontributeve sociale, f. 9).
- g. Në konkluzion rezulton se deri në vitet 2001 – 2002 në Greqi nuk ka pasur ligj që të rregullonte pozitën e emigrantëve të ligjshëm, për sa i përket kontributeve sociale, në kushtet kur ka pasur vakum ligjor.

Në përfundim të kësaj çështjeje, subjekti, mbështetur në këtë analizë, ka pretenduar se rezulton se ka qenë në pamundësi të vetë vendit pritës të kontrollonte flukset e emigrimit nga Shqipëria, jo vetëm në periudhën e emigrimit të tyre, por edhe vite më vonë, për t’u rregulluar me akte ligjore që nisën të zbatoheshin vetëm pas vitit 2002.

Subjekti, gjithashtu, ka vënë në dispozicion të Komisionit si provë, emrat konkretë të disa prej punëdhënësve (të cilët kanë ndërruar jetë) në Greqi, e konkretisht, shtetasit J. S., ing. F. K., P., dhe J. K., pronarë të biznesit “****” (kompani peshkimi), të cilët kanë falimentuar në vitin 2004.

Subjekti ka sqaruar se ekziston pamundësia objektive e gjurmimit të personave të ndjerë, për vetë logjikën e fakteve.

Në përfundim të parashtrimeve të saj, në lidhje me këtë çështje, subjekti ka pretenduar se: *“Në këtë situatë faktike, vlerësoj se gjendemi edhe për arsye të ekzistencës së disa rrethanave që sipas vlerësimit tim më vendosin në kushtet e nenit 32, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon: “[...] Nëse subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t’i vërtetojë institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër. Institucionet e rivlerësimit vendosin nëse mosparaqitja e dokumenteve justifikuese është për shkaqe të arsyeshme [...].”*

Arsyetimi ligjor

Komisioni, pasi vlerësoi provat e depozituara nga subjekti, shqyrtoi parashtrimet dhe shpjegimet e saj të paraqitura me shkrim dhe pasi e dëgjoi në seancë dëgjimore, si dhe duke marrë parasysh vetë kohën në të cilën janë krijuar këto të ardhura të shpjeguara si më lart, konstaton se ato janë realizuar shumë kohë para miratimit dhe hyrjes në fuqi të paketës Kushtetuese të Reformës në Drejtësi duke përfshirë dhe ligjin nr. 84/2016, të cilët përcaktuan rregulla specifike në drejtim të provueshmërisë së burimit të krijimit të të ardhurave të siguruara nga subjektet e rivlerësimit, për efekt të kontrollit e verifikimit të pasurive të tyre.

Ky burim të ardhurash është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit që në deklarinim për herë të parë në vitin 2003. Për më tepër, këto të ardhura kanë qenë të depozituara në sistemin bankar që në vitin 1998, duke shuar çdo dyshim për abuzim nga subjekti me burimin e të ardhurave vetëm në funksion të deklarimit “Vetting”. Pra, nuk jemi përpara rastit kur këto të ardhura deklarohen rishtas vetëm në deklaratën “Vetting” për qëllime të procesit të rivlerësimit. Të ardhurat kanë qenë të deklaruara që në deklarinim fillestar dhe të depozituara rregullisht brenda sistemit bankar në mënyrë periodike, çka i bën ato të besueshme dhe të provueshme.

Komisioni mban në konsideratë faktin se subjekti i rivlerësimit është bërë gjyqtare në maj të vitit 2000, duke i lindur detyrimi prej këtij momenti për të ruajtur dokumentacion që provon ligjshmërinë e të ardhurave. Pra, këto të ardhura janë krijuar në periudhën jashtë ushtrimit të funksionit të subjektit të rivlerësimit.

Në vazhdim të arsyetimit ligjor konstatohet gjithashtu se për një pjesë të kohës së krijimit të këtyre të ardhurave (1990 – 1994), subjekti nuk ishte lidhur në martesë me bashkëshortin dhe për këtë shkak z. S. P., nuk kishte ndonjë detyrim ligjor për të ruajtur dokumentacionin që provon ligjshmërinë e të ardhurave të tij në atë kohë nën frymën e ligjit nr. 84/2016. Rrjedhimisht, ato përbëjnë të ardhura që janë krijuar nga personi i lidhur përpara periudhës së rivlerësimit, në kuptim të pikës 12, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016.

Standardi i provueshmërisë për këto të ardhura duhet të jetë ai i nxjerrjes së justifikimit bindshëm edhe për një nivel më të ulët të provave se sa do të duhej për të kënaqur standardin e provueshmërisë për pasuritë e vëna gjatë periudhës së rivlerësimit. Kjo mënyrë e të arsyetuarit lidhet me logjikën se këto pasuri presupozohen që janë vënë duke mos abuzuar me detyrën (që efektivisht nuk mbahej), dhe për pasojë, duke shmangur për këto pasuri mosbesimin e publikut drejt ligjshmërisë së tyre.

Komisioni mban parasysh në arsyetimin e tij edhe masën e të ardhurave të pretenduara nga subjekti në shumën prej 3.500.000 lekësh gjatë periudhës së emigracionit sezonal 1991 – 2004, si dhe emigracionit të plotë për vitet 1995 – 1996, ku figuron i siguruar që prej datës 16.10.1995. Në këtë periudhë subjekti ka qenë me leje lindjeje.

Bazuar në kuadrin ligjor të Republikës së Greqisë⁴, rezulton se të siguruarit pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore (IKA) dhe anëtarëve të familjes së tij, i jepet mbulim shëndetësor në rast se i siguruari ka realizuar 50 ditë punë gjatë vitit paraardhës. Pajisja e djalit të subjektit me këtë

⁴ Paragrafi 1, i nenit 31, i ligjit nr. 1846/1951, përpara ndryshimit të tij me paragrafin 19, të ligjit nr. 3232/2004. Për më shumë shikoni: <https://www.ilo.org/dyn/travail/docs/1519/social%20security%20greece%201.pdf>

libër të shëndetit të fëmijës të krijon bindjen se bashkëshorti i subjektit ka qenë i siguruar dhe nga ky sigurim djali i tyre ka përfituar librin e shëndetit.

Pra, sipas kësaj prove (librit të shëndetit) provohet edhe një herë periudha e emigrimit në Greqi dhe qenia e familjes së subjektit në Veria të Greqisë, pikërisht në vitin 1995, e cila përkon edhe me provën shkresore të regjistrimit të bashkëshortit të subjektit, z. S. P., si i punësuar në Greqi.

Fakti që për shkak të një realiteti historik të zhvillimit të shoqërisë shqiptare në vitet e tranzicionit, shqetësimi parësor nuk ishte ruajtja e dokumenteve të çdo lloj aktiviteti që prodhonte të ardhura, më tepër se sa nevoja reale e nxjerrjes dhe e realizimit të këtyre të ardhurave në funksion të qëllimit për të siguruar jetesën. Koha e largët në të cilën janë krijuar këto të ardhura e bën të vështirë edhe vetë ruajtjen e dokumentacionit që mund të silltet edhe për shkak të një logjike normale ligjore që duket se nuk merr përsipër të ruajë apo arkivojë dokumente të këtij natyre për një periudhë kaq të gjatë kohe, madje as nga vetë institucionet shtetërore greke.

Punësimi në emigracion i padokumentuar, siç rezulton edhe sot e kësaj dite, nuk rëndon mbi punëmarrësin, por mbi punëdhënësin ndaj dhe mbetet përgjegjësi e punëdhënësve dhe autoriteteteve në shtetet përkatëse që të kontrollojnë këto veprimtari. Rrjedhimisht, të metat e tyre nuk mund t'iu atribuohen shtetasve punëkërkues, për më tepër kur kemi të bëjmë me një marrëdhënie përpara 28 vitesh. Në një kohë që llogaridhënia mbetet parim në vlerësimin e aktivitetit të gjithkujt, atëherë kur ajo shtrihet në të meta të lejuara dhe informalitet të lejuar nga vetë shtetet, nuk mund të penalizojë individin.

Një qëndrim të tillë e gjejmë edhe në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, mbi pamundësinë e cenimit të sigurisë juridike të individit, për rastet kur vetë shteti pranon dhe lejon të meta dhe informalitet, të vendosur si standard minimal të pacenueshëm nga shtetet palë të KEDNJ-së, në çështjen e kësaj gjykate, *** kundër Turqisë (ankimi nr. ***, vendim i vitit 2004, i Dhomës së Madhe të GJEDNJ-së).

Në përfundim, Komisioni vlerëson të gjitha përpjekjet e bëra nga subjekti për kërkimin e provës, si pasojë e të cilave ka arritur të sigurojë të paktën një pjesë dokumentacioni që provon punësimin e ligjshëm në Greqi në vitin 1995, ku konstaton se subjekti ndodhet në kushtet e pamundësisë objektive për të disponuar dokumente që justifikojnë të ardhurat e deklaruara nga punësimi në emigracion. Në këtë vlerësim, Komisioni mban parasysh, përveç kohës shumë të largët, edhe faktin se një pjesë e tyre janë krijuar para lidhjes së martesës së subjektit, përpara periudhës së punësimit të subjektit si gjyqtare, të depozituara periodikisht në sistemin bankar, si dhe faktin se këto të ardhura janë të fituara nga vetë subjekti dhe bashkëshorti i saj, dhe jo të dhuruara, qoftë edhe nga persona në lidhje të afërt gjinore.

Komisioni vlerëson se në arsyetimin e tij duhet të mbajë parasysh domosdoshmërisht rrethana të tilla si: *“Flukset sociale, të karakterizuara nga lëvizje të forta migratore; informaliteti i ekonomisë shqiptare në këto vite; remitancat nga jashtë në nivele të larta, të pashoqëruara me burime legale të pagesës nga punëdhënësit dhe të pataksuara në Shqipëri; ballafaqimi me konceptin e taksimit mbi të ardhurat në një mënyrë të plotë vetëm pas miratimit të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998; deklarata e integruar e të ardhurave personale e zbatuar vetëm pas vitit 2012; licencimi i së parës bankë të nivelit të dytë në vitin 1999; pagesat e pagave nëpërmjet sistemit bankar vetëm pas viti 2002...”*⁵

Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës të ardhura të ligjshme do të konsiderohen ato të ardhura për të cilat janë paguar tatimet. Komisioni vlerëson se mbi të ardhurat e përftuara nga puna si veprimtari sezonale, referuar fakteve dhe provave të paraqitura më lart, duhet të jenë mbajtur në burim nga punëdhënësi, taksat dhe tatimet përkatëse, në shtetin grek. Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka paraqitur, në cilësinë e provës, kopje të pasaportës së tij, nga ku vërtetohet se ai ka qenë pajisur vijimisht me viza nga autoritetet greke, çka provon se ai ka qenë një punëkërkues i ligjshëm. Po kështu, rezultojnë hyrje-dalje në shtetin grek në periudha të shkurtra, që fillojnë nga dy ditë, një javë, apo dy javë, përkatësisht, udhëtime të kryera nga bashkëshorti i subjektit në vitin

⁵ Komentar mbi Reformën Kushtetuese në Sistemin e Drejtësisë (2016), Publikim i OSFA-së dhe ISPL-it, Tiranë, 2019, f. 532 - 535.

1999 dhe nga subjekti i rivlerësimit në vitet 1996, 1997, 2000 dhe 2002, duke përkuar me shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe situatën konkrete.

Komisioni e konsideron këtë provë të besueshme për sa i përket të ardhurave që rrjedhin nga punësimi në shtetin grek. Komisioni vlerëson se është fakt i ditur botërisht, se në periudhën kohore objekt shqyrtimi, kontrolli i ambasadës mbi dokumentacionin për dhënien e vizës ishte shumë i rreptë. Fakti i pajisjes me viza në mënyrë të shpeshtë, vërteton se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, ka paraqitur dokumentacion që ishte i punësuar, për faktin se e ka kaluar këtë kontroll edhe duke paraqitur dokumentacionin e nevojshëm, por meqenëse ka kaluar një kohë tepër e gjatë, dokumentacioni nuk mund të gjendet i plotë. Në këto rrethana, shpjegimet konkrete të subjektit, rrethanat e detajuara të faktit, moshja e re për punë, njohja e gjuhës dhe pasja e kombësisë greke, certifikata e regjistrimit për bashkëshortin e siguar drejtpërdrejtë, të lëshuar nga autoritetet kompetente greke, emrat konkretë të disa prej punëdhënësve, të gjitha të gërshetuara, provojnë megjithëse me prova pjesërisht indirekte, se subjekti ka punuar në shtetin grek në mënyrë të ligjshme, dhe për pasojë, edhe në përputhje me legjislacionin e kohës të atij shteti. Në këtë mënyrë, subjekti ka argumentuar ligjshmërinë e lëvizjes në Greqi, qëndrimin në atë shtet dhe ka vënë në dispozicion dokumente, për aq sa ato kanë qenë të mundshme për t'u siguruar, për të provuar të ardhurat e realizuara në atë shtet.

Në bazë të pikës 2, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës është përcaktuar se: *“Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Elemente të tjera të pasurisë së ligjshme përcaktohen me ligj”*. Komisioni vlerëson se në interpretim dhe zbatim të këtij përcaktimi kushtetues, për të ardhurat e përftuara nga puna, tatimi mbahet në burim nga punëdhënësi, sidomos kur janë prodhuar jashtë shteti dhe në shuma që janë afër pragut minimal të pagës mujore minimale që përjashtohet nga taksat dhe tatimet dhe nuk është në përgjegjësinë e të punësuarit.

Komisioni mban parasysh edhe faktin se nisur nga kalimi i një periudhe kohore kaq të gjatë, eventualisht e gjen të drejtë kërkesën për përjashtimin e subjektit të rivlerësimit nga detyrimi për paraqitjen e dokumenteve që justifikojnë ligjshmërinë e krijimit të pasurive, sipas nenit 32, pika 2, e ligjit nr. 84/2016 duke vlerësuar edhe të gjitha përpjekjet e tij për të provuar deklaratimet e bëra.

Duke mbajtur në konsideratë arsyetimin logjik më lart, duke e parë në tërësi kuptimin e normës kushtetuese që rregullon konceptin e të ardhurave të ligjshme, të ardhurat e deklaruara nga puna në emigracion, deklaruar me vërtetësi përgjatë gjithë këtij procesi për blerjen e këtij apartamenti, duhet të konsiderohen burime të ligjshme.

ii. Aktiviteti tregtar i bashkëshortit

Si burim për blerjen e këtij apartamenti subjekti ka deklaruar edhe aktivitetin tregtar të bashkëshortit në vitet 1995 – 1996, në shoqërinë “****” sh.p.k., regjistruar me vendimin nr. ***, datë 26.7.1995, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Nga hetimi i Komisionit ka rezultuar se shtetasi S. Ll. P., ka qenë administrator dhe ortak zotërues i 50 % të kuotave të kapitalit në shoqërinë “****” sh.p.k., i regjistruar me vendim gjyqësor nr. ***, datë 26.7.1995, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Z. S. P., me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 17.1.1997, është larguar nga shoqëria, duke shitur kuotat e tij tek ortaku tjetër i shoqërisë, z. S. K.

Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastrë, me shkresën nr. *** prot., datë 16.10.2018, ka informuar se ky subjekt figuron i regjistruar me NIPT *** në datën 1.7.1996, me aktivitet “Tregti me shumicë dhe ndërmjetësimi tregtar përveç mjeteve të transportit automobilistik”, kaluar në status pasiv në datën 1.7.1996.

Në dosjen e subjektit nuk ka të dhëna për fitimin e realizuar në vitet (1996 – 1997) apo shpërndarjen e fitimit të realizuar.

Sipas vendimit nr. ***, datë 17.1.1997, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ortaku i vetëm i shoqërisë është z. S. K., me 100 % të kapitalit, dhe për këtë është depozituar fotokopje e vendimit.

Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastër ka vënë në dispozicion:

- vendimin gjyqësor nr. ***, datë 26.7.1995, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë;
- aktin e themelimit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, “****” sh.p.k.;
- statusin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, “****” sh.p.k.

Në përfundim të hetimit, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës, për të provuar të ardhurat në shumën 200.000 lekë, pasi nuk rezultojnë të dhëna mbi fitimin e realizuar.

Në parashtrimet e tij, subjekti ka sqaruar: *“Aktiviteti tregtar i këtij shoqërie konsistonte në një mjet të vetëm transporti makine në pronësi të z. S. K., (kunati i bashkëshortit) shofer makinash të rënda në profesion. Aktiviteti konsistonte vetëm në transport të mallrave për të tretët. Pozita e bashkëshortit tim si “ortak” në këtë shoqëri është thjesht kërkesë e ligjit të kohës. Nuk kanë pasur asnjë send të paluajtshëm të marrë me qira, asnjë faturë tej atyre të transportit, nuk kanë pasur kontabilist, nuk rezultojnë debitorë ndaj shtetit, domethënë paguanin taksat, hiqin shpenzimet e mjetit dhe ajo çka mbetej, e ndanin me njëri-tjetrin. Çmoj se ka qenë në pamundësi apo në vështirësi për shkak të kohës (kujtojmë viti 1996 – 1997) administrimi i dokumentacionit të plotë që Drejtoria Rajonale Gjirokastër të ketë pasur mundësi të plota verifikimi të dokumenteve të këtij aktiviteti për periudhën 1996 – 1997. Vlera prej 200.000 lekësh që ne kemi deklaruar si fitim është një pagesë minimale një llogari e thjeshtë prej 10.000 lekësh në muaj për periudhën kohore një vit e gjysmë që im shoq ndihmonte në këtë aktivitet kunatin e tij. Në këtë periudhë kohore mbajtur në konsideratë edhe ngjarjet që ndodhën në vitin 1997, nuk bëhej fjalë për ndarje dividendi në një aktivitet kaq të thjeshtë. Sqaroj se ky aktivitet kryhej nga kunati i bashkëshortit, z. S. K., që edhe kishte pronësinë e makinës (trajler) me targa *** dhe targë rimorkio ***, ndërsa bashkëshorti ishte ndihmës i tij për shkak të arsimit për dokumentacionin ligjor apo për të gjetur treg pune në Greqi për shkak të qenies në këtë kohë aty si emigrant. Nga studimi i dokumentacionit që ju keni marrë për këtë moment (shkresa e marrë nga ana juaj pranë DRT-së Gjirokastër me nr. ***), rezulton se kjo shoqëri nuk ka asnjë detyrim dhe asnjë vlerë borxhi, çka nënkupton se primare edhe në atë kohë, ka qenë shlyerja e detyrimeve tatimore dhe çfarë mbetej, ndahej mes tyre.”*

Arsyetimi ligjor

Komisioni konstaton se subjekti me anë të shpjegimeve ka arritur të provojë përfundimin e këtyre të ardhurave. Nga të gjitha të dhënat e faktit dhe rrethanat ka rezultuar dhe provuar se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit është regjistruar në regjistrin përkatës si ortak i shoqërisë tregtare, duke kryer edhe rolin e administratorit. Komisioni vlerëson se këto të dhëna janë të mjaftueshme për ta konsideruar veprimtarinë e administratorit të shoqërisë si veprimtari që rrjedh nga një marrëdhënie si ajo e punësimit, tatimi i të cilave duhet të ishte mbajtur në burim. Fakti se nuk ka të dhëna për fitimin e realizuar në periudhën (1996 – 1997) dhe shpërndarjen e fitimit të realizuar, nuk do të thotë se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit nuk ka ushtruar veprimtari të ngjashme me ato të një marrëdhënieje punësimi dhe nuk ka përfituar të ardhura të ligjshme, nisur kjo edhe nga vlera e të ardhurave të pretenduara. Në rastin konkret, Komisioni ka parasysh edhe ngjarjet e vitit 1997, të cilat përbëjnë një fakt të njohur botërisht, lidhur me djegien apo mungesën e dokumentacionit, si dhe mosfunksionimin si duhet të administratës publike.

Shuma e të ardhurave në raport me kohëzgjatjen e punësimit/ortakërisë në këtë shoqëri duket në një raport të pranueshëm, siç edhe ka shpjeguar dhe pretenduar subjekti (vlera e deklaruar si e përftuar prej 200.000 lekësh, ose rreth 1500 euro, për dy vjet aktivitet tregtar, duke përfshirë edhe vlerën e çmimit të shitjes së kuotës sipas vendimit nr. ***, datë 17.1.1997).

Komisioni arrin në përfundimin logjik se të ardhurat e krijuara nga veprimtaria tregtare e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, të deklaruara për blerjen e këtij apartamenti, duhet të konsiderohen të ligjshme.

iii. Të ardhura nga shpronësimin i një trualli për interes publik

Nga provat e administruara, Komisioni konstaton se në faqen⁶ e gazetës “***” është pasqyruar lista shtesë e personave që shpronësohen për efekt të ndërtimit të superstradës Korçë -Kapshticë. Ndër të tjerë, është edhe emri i subjektit të rivlerësimit (nr. rendor ***), si pronare e truallit me sip. 180 m², vlerësuar me çmim 4.000 lekë/m².

Komisioni, me shkresën nr. *** prot., datë 10.10.2018, drejtuar ARRSH-së, kërkoi informacion në lidhje me këtë shpronësim.

ARRSH-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 18.10.2018, ka informuar se:

“Pasuria në pronësi të subjektit Regleta Panajoti është shpronësuar nga ndërtimi i segmentit rrugor Korçë – Kapshticë, me VKM-në nr. 169, datë 30.3.2001, për sipërfaqen 180 m², me vlerë shpronësimi 720.000 lekë, likuiduar në Bankën e Kursimeve, dega Korçë.”

ARRSH ka vënë në dispozicion:

- vendimin e Këshillit të Ministrave, bashkëlidhur të cilit është edhe lista e personave që shpronësohen;
- shkresën nr. *** prot., datë 20.11.2001;
- listëpagesën e personave që shpronësohen për efekt të ndërtimit të superstradës Korçë-Kapshticë;
- shkresën nr. *** prot., datë 6.7.2001, të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve me lëndë “Sqarim për listëpagesën e pronarëve Korçë”;
- planimetrinë e shpronësimit ku pasqyrohet prona në fjalë.

Në listën e personave që shpronësohen për pasurinë e paluajtshme tokë bujqësore dhe troje nr. *** -***, e administruar në dosjen e Komisionit, ndër të shpronësuarit e tjerë pasqyrohet edhe subjekti i rivlerësimit, znj. Regleta Panajoti, si përfituese e të ardhurave në **shumën prej 720.000 lekësh**, për një sipërfaqe toke 180 m², me vlerë 4.000 lekë/m².

Komisioni ka konstatuar se deklarimi është i saktë dhe i dokumentuar, dhe se subjekti ka përfituar këto të ardhura nga një burim i ligjshëm.

iv. Të ardhura nga punësimi i bashkëshortëve

Nisur nga të dhënat dhe informacionet e administruara në dosjen e ILDKPKI-së dhe dosjen e Komisionit, janë marrë në konsideratë të ardhurat e përfituara nga pagat e subjektit të rivlerësimit të pasqyruara në vërtetimet përkatëse të institucioneve punëdhënëse dhe ISSH-së dhe njëkohësisht edhe ato të bashkëshortit të pasqyruara në vërtetimet përkatëse të institucioneve punëdhënëse, por edhe ato të administruara nga informacionet e ISSH-së, apo informacionet e pasqyruara në vërtetimet e ardhura nga Drejtoria e Arkivit Lundër për periudhat e punësimit përpara vitit 2012, konkretisht, informacione të cilat saktësojnë përfitimin e të ardhurave, si dhe kontributet e derdhura për personin e lidhur.

Tabela 1

Periudha	1995 - 31.12.2001
Të ardhura nga paga e subjektit ⁷	1.394.412
Të ardhura nga paga e bashkëshortit të subjektit ⁸	2.697.256
Shuma totale e të ardhurave të përfituara nga subjekti dhe bashkëshorti	4.091.677

Shpenzimet e jetesës për periudhën 1995 – 2001 rezultojnë në vlerën 1.914.000 lekë.⁹

⁶Nr ***, datë 22.2.2001 (Aneks nr. 4/14 në dosjen e ILDKPKI-së).

⁷ Të ardhurat nga paga të subjektit të rivlerësimit sipas dokumentacionit të administruar në dosjen e ILDKPKI-së për periudhën 1995 – 2001.

⁸ Të ardhurat nga paga e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit sipas dokumentacionit të administruar në dosjen e Komisionit nga Arkiva e ISSH-së për periudhën 1997 – 2001.

⁹ Për periudhën 1995 – 1999 shpenzimet e jetesës janë llogaritur 5.000 lekë në muaj për frymë, kurse për vitet 2000 – 2001 janë llogaritur 9.000 lekë në muaj për frymë sipas shkresës nr. *** prot., datë 4.3.2019, të ILDKPKI-së.

Në shpjegimet e saj, subjekti ka shpjeguar lidhur me të ardhurat nga paga e bashkëshortëve, si dhe të ardhurat e tjera të tyre të cilat kanë shërbyer si burim për këtë pasuri, duke vënë në dispozicion të Komisionit edhe dokumente provuese.

Subjekti ka depozituar një vërtetim nga Banka Kombëtare e Greqisë, sh.a., dega Tiranë (***), me nr. ***, datë 7.2.2003, sipas të cilit bashkëshorti i subjektit, z. S. P., i punësuar pranë kësaj banke, është paguar që nga muaji shkurt i vitit 1997 deri në fillim të vitit 2002, me pagë mujore *bruto* në shumën 530 (pesëqind e tridhjetë) euro, pra, në total 31.270 euro.

Gjithashtu, subjekti ka depozituar vendimin nr. ***, datë 13.4.1999 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, sipas të cilit Ministria e Mbrojtjes detyrohet të trajtojë me pagesë kalimtare paditësin S. P., në vlerën 126.554 lekë, për periudhën dyvjeçare pas nxjerrjes në lirim.

Nga dokumentacioni i depozituar rezultoi se të ardhurat e zotit S. P., për periudhën 1986 – 1994 rezultojnë në shumën 118.680 lekë, ndërsa të ardhurat e subjektit të rivlerësimit për periudhën 1995 – 2001 rezultojnë në shumën 1.435.612 lekë.

Po ashtu, subjekti ka shpjeguar se përveç të ardhurave nga paga të dokumentuara me dokumentacion ligjor provues, kanë pasur edhe të ardhura në shumën prej 150.000 lekësh nga shoqëria piramidale “Vefa”.

Tabela 2

Përshkrimi	Periudha	Shuma
Të ardhura nga paga, subjekti	1995 – 2001	1.394.412
Të ardhura nga paga, bashkëshorti i subjektit	1997 – 2001	2.697.256
Të ardhura nga paga, bashkëshorti i subjektit	1986 – 1994	157.900
Total		4.249.568
Të ardhura të tjera		
Të ardhura me vendim gjykatë të vitit 1999	1999 – 2000	126.554
Të ardhura të përfituara nga shoqëria “VEFA”	1997 – 1998	150.000
Total		276.554

Arsyetimi ligjor

Nga analiza ekonomike mbi të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit ka rezultuar se ata kanë pasur të ardhura nga paga në masën 4.249.568 lekë deri në vitin 2001 (kohë në të cilën kanë blerë edhe apartamentin), si dhe të ardhurat e tjera të pretenduara nga subjekti në shumën 126.554 lekë, nga trajtimi me pagesë kalimtare për shtetasin S. P., nga Ministria e Mbrojtjes, dhe të ardhura në masën 150.000 lekë nga shoqëria piramidale “Vefa”.

Lidhur me të ardhurat në shumën 150.000 lekë nga shoqëria piramidale “Vefa”, të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni nuk i pranoi ato si burim për blerjen e apartamentit, por i vlerësoi si të ardhura potencialisht të mundshme në përdorim nga subjekti i rivlerësimit.

14.4 Vlerësimi tërësor i rezultateve të hetimit dhe provave e shpjegimeve të subjektit për pasurinë apartament banimi, me sip. 104.23 m², ndodhur në “****”, Tiranë, blerë në vitin 2002.

Në përfundim të analizës, lidhur me mundësitë e subjektit të rivlerësimit për blerjen e apartamentit në vlerën prej 47.000 USD, Komisioni konkludon se subjekti i ka pasur mundësitë financiare për përballimin e këtij shpenzimi.

Ky konkluzion arrihet nëpërmjet arsyetimit të bazuar në dokumentacionin e paraqitur për të ardhurat nga emigracioni ekonomik (sezonal dhe i plotë) në Greqi dhe arsyetimin logjik mbi këto të ardhura; të ardhurat nga shpronësimi në shumën 720.000 lekë; të ardhurat nga aktiviteti tregtar i bashkëshortit në shumën prej 200.000 lekësh, si dhe të ardhura nga punësimi i bashkëshortëve, të cilat rezultojnë në shumën 4.249.568 lekë; të ardhurat të tjera nga vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, në shumën 126.554 lekë.

Për sa më sipër, provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, së bashku me shpjegimet e saj, kanë provuar atë çka ka qenë objekt i gjetjeve të Komisionit. Megjithëse kjo pasuri i përket një kohe relativisht të largët për të cilën subjekti gjendet në pamundësi objektive për të provuar me dokumentacion ligjor provues ligjshmërinë e të ardhurave të krijuara, ajo është përpjekur maksimalisht për të paraqitur prova dhe për të bindur Komisionin se deklaratimet e saj kanë qenë të sakta dhe se të ardhurat kanë qenë nga burime të ligjshme. Komisioni konstaton se në vlerësimin tërësor të kësaj pasurie nuk mbeten dyshime apo të krijohen indice lidhur me këtë pasuri të subjektit të rivlerësimit. Në analizë të provave dhe shpjegimeve, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë pasur mundësitë financiare për krijimin e këtij pasurie. Subjekti i rivlerësimit ka arritur të provojë në mënyrë bindëse në lidhje me mundësitë financiare për krijimin e kësaj pasurie.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit bëri të gjitha përpjekjet për të provuar dhe arritit të shpjegojë e të paraqese argumente logjike dhe juridike, lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave për blerjen e pasurisë apartament banimi me sip. 104.23 m², “****”, Tiranë. Koha e largët e krijimit të të ardhurave nga emigracioni për blerjen e kësaj banese, statusi i bashkëshortëve Panajoti, si dy qytetarë të thjeshtë (emigrantë), si dhe mungesa e deklaratimeve në ato vite, duhen konsideruar si rrethana lehtësuese. Subjekti i rivlerësimit bëri të gjitha përpjekjet për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave, paraqiti prova dhe dokumente shtesë, dhe të gjitha shpjegimet dhe provat e paraqitura prej saj të krijojnë bindjen se ka qenë e saktë në deklaratimet e bëra dhe se të ardhurat për blerjen e kësaj pasurie kanë qenë nga një burim i ligjshëm që është puna e vetë bashkëshortëve në ato vite.

15. **Apartament banimi** me sip. 64.80 m², ndodhur në “****”, Tiranë, blerë me kontratë sipërmarrje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.10.2007, kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. ***kol., datë. 17.11.2012 dhe certifikatë pronësie datë 8.1.2015. Çmimi: 50.000 euro.

15.1 Burimi i deklaruar i krijimit sipas deklaratës “Vetting”: punësimi, shitja e pasurisë së paluajtshme në Korçë, kontrata e huas.

15.2 ZVRPP-ja Tiranë¹⁰ ka konfirmuar ekzistencën e kësaj pasurie, në bashkëpronësi të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj, z. S. Ll. P. (person i lidhur).

Lidhur me këtë apartament, subjekti ka deklaruar se:¹¹ “... apartamentin me sip. 64.80 m² e ka përdorur për banesë herë pas here nipi i bashkëshortit (djali i motrës së tij, z. P. K., me familjen), i cili punon në Tiranë në Fabrikën e Aluminit, ku është i punësuar shofer i rrugës Shqipëri - Greqi që nga viti 2005 e në vazhdim. Periodikisht kanë banuar edhe prindërit e mi biologjikë deri sa përfundoi shtëpia e tyre, ka banuar edhe im bir pasi u bë madhor. Në vitin 2018 ia kemi dhënë me qira, z. F. N., kjo edhe në kushtet kur fëmijët u larguan me studime dhe nipi i burrit u vendos me banim në Veria, të Greqisë. Marrëdhënia e qirasë u formalizua në kontratë në shkurt të vitit 2018.”

Subjekti ka vënë në dispozicion kopje të kontratës së qirasë datë 12.2.2018 dhe tatim mbi qiranë të shlyer rregullisht.

15.3 Nga deklaratimet e administruara nga Komisioni ka rezultuar se kjo pasuri është deklaruar nga subjekti dhe personi i lidhur si në vijim:

- a. Në deklaratën e pasurisë për vitin 2007, si apartament, pasuri e paluajtshme me sipërfaqe 74.6 m², me kontratë sipërmarrjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.10.2007, të noter M. P., me shoqërinë “****” sh.p.k., në shumën 50.000 euro, në pjesë takuese 50 %, nga të cilat, në vitin 2007 është paguar shuma 40.000 euro.
- b. Nga personi i lidhur (bashkëshorti i subjektit) në deklaratën e pasurisë për vitin 2013, si pasuri e fituar me kontratën e shitblerjes së sendit nr. ***, datë 17.11.2012, noter Y. Ç., me çmim të paguar dhe deklaruar në deklaratën e vitit 2008, ende e paregjistruar në ZVRPP.
- c. Nga personi i lidhur (bashkëshorti) në deklaratën e pasurisë për vitin 2014 si “Pasuria e fituar nga kontrata e shitblerjes, datë 17.11.2012, e deklaruar vite më parë, e regjistruar në ZVRPP-

¹⁰ Sipas dokumenteve bashkëngjitur shkresës nr. *** prot., datë 24.9.2018, të ZVRPP-së Tiranë në dosjen e Komisionit.

¹¹ Referojuni përgjigjes së pyetjes 6 në pyetësorin nr. 2, datë 6.11.2018, në dosjen e Komisionit.

në Tiranë dhe e pajisur me certifikatë pronësie në datë 8.1.2015, me sipërfaqe 64.80 m², në pjesë ideale ½”.

- d. Në deklaratën “Vetting” si pasuria – apartament banimi me sip. 64.8 m², “****”, hyrja nr. ***, apartamenti nr. ***, Tiranë, fituar me kontratë sipërmarrjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.10.2007, noter M. P., kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.11.2012, noter Y. Ç., certifikatë pronësie datë 8.1.2015, në vlerën 50.000 euro.
- e. Në deklaratën “Vetting”, burimi i krijimit për këtë pasuri, është deklaruar: punësimi, shitja e pasurisë së paluajtshme në Korçë, kontrata e huas.
- f. Në deklaratën e pasurisë për vitin 2007, vit në të cilin është nënshkruar sipërmarrja e pasurisë në shumën 50.000 euro, nuk është deklaruar burimi i pagesave të kryera në atë vit, në shumën prej 40.000 euro.

15.4 Komisioni analizoi burimin e deklaruar në “Vetting” nga subjekti, për krijimin e këtij pasurie, duke konsideruar të tria burimet e deklaruara: (i) të ardhura nga punësimi; (ii) shitja e pasurisë së paluajtshme në Korçë; (iii) hua në vlerën 10.000 euro.

i. Lidhur me të ardhurat e krijuara nga punësimi, të deklaruara si burim për krijimin e kësaj pasurie, nga Komisioni u morën në analizë:

- të ardhurat e akumuluar ndër vite;
- të ardhurat në vitin në të cilin është blerë pasuria.

Për sa u përket të ardhurave të akumuluar ndër vite, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar kursime *cash* në banesë, prandaj u mor në konsideratë vetëm shuma 320.177 lekë, e cila është diferenca midis gjendjes së llogarive bankare në datën 31.12.2006¹², dhe në datën 31.12.2007¹³.

Në lidhje me të ardhurat e vitit 2007, subjekti dhe bashkëshorti rezultojnë të kenë realizuar të ardhura prej 3.042.859 lekësh, nga të cilat shuma 1.099.281 lekë rezultojnë të kenë shkuar për mbulimin e shpenzimeve. Pra, mundësia e subjektit për të kursyer apo për të investuar ka qenë në vlerën $3.042.859 - 1.099.281 = 1.943.578$ lekë.

Në përfundim, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi të përdorë si burim për blerjen e kësaj pasurie shumën prej 2.263.755 lekësh, nga të ardhurat e punësimit duke konsideruar të ardhurat ndër vite dhe të ardhurat në vitin korrent.

ii. Shitja e pasurisë së paluajtshme në Korçë

Në deklaratën “Vetting”, si një nga burimet e të ardhurave për blerjen e apartamentit në vitin 2007, subjekti ka deklaruar shitjen e pasurisë së paluajtshme në Korçë. Nga hetimi administrativ ka rezultuar se këto të ardhura të siguruara nga shitja janë përshkruar si burim për krijimin e depozitës prej 20.000 USD në “Alpha Bank”, si në deklarinimin për herë të parë në vitin 2003, ashtu edhe në pyetëtorin nr. 2.

Përveç pamundësisë që të ardhurat nga shitja e kësaj pasurie të përdorej për mbulimin e blerjes së pasurisë nr. 1 (për faktin se shitja është kryer më pas se blerja e realizuar në vitin 2002), lidhur me këtë burim, nga analiza e fakteve rezultojnë se:

- nga viti 2003 dhe deri në momentin e blerjes së pasurisë nr. 2 (datë 2.10.2007), subjekti nuk ka deklaruar kursime *cash* në banesë;
- gjendja e llogarive bankare në datën 31.12.2006 rezultojnë të ketë qenë në vlerën 834.136 lekë;
- depozita në “Alpha Bank” ka qenë në vlerën 20.000 USD¹⁴, por e ardhura nga shitja e truallit në Korçë nuk mund të ishte pjesë përbërëse e kësaj shume, pasi ajo, sipas deklarinimeve të subjektit, ishte krijuar përpara vitit 2003, ndërsa kontrata e shitblerjes së truallit në fjalë është e datës 11.3.2004.

¹² Shuma 834.136 lekë.

¹³ Shuma 513.959 lekë.

¹⁴ Mbetet i pakonfirmuar destinacioni dhe përdorimi, pasi kjo shumë është tërhequr më 7.3.2005, por në deklarinimin e vitit 2007 subjekti e deklaroi si shumë të tërhequr dhe të përdorur për pagesën e pasurisë nr. 2.

Në vijim të analizës së mësipërme, të ardhurat nga shitja e kësaj pasurie (truall me sip. 634 m² në Korçë) mund të shërbenin si burim krijimi i pasurisë nr. 2 vetëm në mënyrë indirekte, përmes depozitës bankare, por në vitin 2004, subjekti ka deklaruar që nuk ka pasur ndryshime në pasurinë e paluajtshme dhe as në atë të luajtshme.

Gjithashtu, pasuria truall me sip. 634 m², ndodhur në Korçë, nuk rezulton të jetë deklaruar si pasuri e poseduar në vitin 2003, dhe as si pakësim pasurie (shitje) në vitin 2004.

Subjektit iu kalua barra e provës në lidhje me këto rezultate të hetimit.

Në shpjegimet e saj subjekti ka sqaruar se pas çeljes së trashëgimisë ligjore të nënës së saj ajo ka fituar pronësinë edhe mbi një parcelë toke me sipërfaqe totale 814 m², ndodhur në Korçë. Në vitin 2001 nga kjo sipërfaqe totale janë shpronësuar për interes publik 170 m². Të ardhurat nga shpronësimi në shumën prej 720.000 lekësh janë përdorur për blerjen e apartamentit në vitin 2002. Pjesa tjetër e kësaj parcele me sip. 634 m² është tjetërsuar *de facto* në vitin 2003 për vlerën 634 m² x 2.800 lekë/m² = 1.775.200 lekë, vlerë e cila është deklaruar, pa asnjë ndryshim, në të gjitha deklaratimet periodike të kohës, por edhe në deklaratën “Vetting”.

Subjekti ka sqaruar se kjo shumë ka shërbyer fillimisht si burim i ligjshëm i krijimit të llogarisë bankare në vitin 2003 në “Alpha Bank” sh.a., në shumën 20.000 USD.

Referuar provave të vëna në dispozicion nga subjekti, rezulton se çmimi i shitjes së kësaj pasurie sipas “Kontratës së shitjes për një kohë të ardhme”, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.5.2003, është paguar përpara noterit në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate, ndërkohë që akti përfundimtar formal i shitjes është bërë në vitin 2004.

Në kushtet kur kjo pasuri është tjetërsuar tërësisht para deklaratimit të parë, atij të vitit 2003 (maj 2003), subjekti nuk ka pasur detyrimin dhe as mundësinë ligjore për ta deklaruar si pasuri të vetën, as në vitin 2003 dhe aq më pak në vitin 2004, sepse ishte zhveshur nga pronësia dhe posedimi *de jure* dhe posedimin *de facto* e kishte marrë blerësi që në pranverën e vitit 2003.

Së bashku me shpjegimet për këtë rezultat të hetimit, subjekti ka depozituar një librezë kursimi në lekë në “Alpha Bank”, nga ku rezulton se ka depozituar, pikërisht në qershor të vitit 2003, vlerën monetare të fituar nga kjo shitje, e cila, mbledhur me depozitën ekzistente, bën në total shumën 2.375.200 lekë (600.000 + 1.775.200 = 2.375.200 lekë).

Nga veprimet në këtë librezë rezulton se veprimi i fundit i tërheqjes së kësaj vlere në lekë është bërë në datën 23.12.2003, në shumën 2.060.400 lekë. Po kështu, nga librezja e dorëzuar në Komision rezulton se në “Alpha Bank” sh.a., në llogarinë në USD, vetëm në datën 24.12.2003 (një ditë më vonë), vlera arrin shumën 20.000 USD. Prandaj, kjo depozitë ka burimin e ligjshëm të krijimit të saj, pikërisht këtë transaksion civil duke shërbyer si burim i krijimit të kësaj depozite bankare.

Në deklarin periodik dorëzuar në datën 21.3.2006 (ku deklarohet viti 2005), në ILDKPKI është deklaruar *interesi i shtuar për këtë depozitë në “Alpha Bank” sh.a. me nr. ***, vlera rreth 200 USD*, dhe në shënimet konfidenciale të formularit është deklaruar edhe shënimi “depozitë e vjetër bankare 2002”.

Edhe në formularin e deklaratimit dorëzuar në datën 15.3.2007 (ku deklarohet viti 2006), si shtesë të kësaj depozite në “Alpha Bank” sh.a., me nr. ***, vlerën vjetore të interesave rreth 200 USD. Ky deklarin periodik për vitin 2006 konfirmon ekzistencën e këtij llogarie në “Alpha Bank” sh.a., edhe për vitin 2006.

Ndërkohë, në formularin e dorëzuar në datën 13.3.2008 (ku deklarohet viti 2007), subjekti ka deklaruar të tërhequr tërësisht dhe të mbyllur këtë llogari në vitin 2007, për të paguar çmimin e apartamentit, pasuria nr. 2.

Në përfundim të shpjegimeve për këtë rezultat të hetimit, subjekti ka theksuar se: “*Pretendimi ynë se depozita bankare në USD ka vazhduar të ekzistojë edhe pas marsit 2005, rezulton edhe nga statement bankar marrë pranë “Alpha Bank” sh.a. në datën 13.6.2019, nga ku identifikohet se kjo depozitë bankare është mbyllur para kohe prej meje në datën 3.10.2007, pikërisht për të paguar*

këstin e parë të pasurisë nr. 2. Në konkluzion, depozita bankare e krijuar në “Alpha Bank” sh.a. në vitin 2002 (sipas shpjegimit më sipër), e cila ka ekzistuar deri në vitin 2007, është përdorur për të paguar pjesë të çmimit të pasurisë nr. 2, në tetor 2007. Ky është shkaku që është deklaruar vlera e përfituar nga shitja e parcelës në vitin 2003 si burim i ligjshëm edhe për depozitën pranë “Alpha Bank” sh.a., dhe mbyllja e kësaj depozite, me qëllim pagimin e çmimit në vitin 2007 si burim i pagimit të çmimit të pasurisë nr. 2.”

Arsyetimi ligjor

Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ka konstatuar se në kontratën e shitjes së datës 11.3.2004, me nr. *** rep., nr. *** kol., të nënshkruar përpara noterit V. M., (në Korçë), rezultojnë njëkohësisht shitja e tri pronësive së bashku (me sip. totale 2.262 m²), të z. F. L., kundrejt një çmimi tërësor prej 1.900.000 lekësh – dhe konkretisht, për blerjen e pasurive: nr. ***, me sip. 814 m² tokë; nr. ***, po me sip. 814 m² tokë, si dhe pronësia që i përkiste subjektit të rivlerësimit me nr. ***, me sip. 634 m² tokë. Rrjedhimisht, pjesa takuese e subjektit nga të ardhurat/çmimi që korrespondon me pronësinë e tij të shitur, me sip. 634 m², rezultojnë të jetë në vlerën rreth 533.000 lekë (634 m² x 840¹⁵ lekë/m²), e cila nuk përputhet me vlerën e përcaktuar në “Kontratën e shitjes për një kohë të ardhme” nr. ***, datë 17.5.2003. Në lidhje me këtë mospërputhje subjekti ka shpjeguar se *çmimi i shitjes ka qenë më i lartë se ai i pasqyruar në kontratë, pasi ka qenë një fiktivitet për të evituar pagesën e taksave, dhe mbi këtë rrethanë ka paraqitur edhe deklaratat noteriale.*

Nga shqyrtimi i kontratave rezultojnë se në atë të nënshkruar në vitin 2003, subjekti ka qenë prezent, por në kontratën përfundimtare të nënshkruar në vitin 2004, subjekti ka qenë me përfaqësim, sipas prokurës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 8.3.2004.

Duke analizuar veprimet në lidhje me fiktivitetin e çmimit në kontratën e vitit 2004, rezultojnë se ajo nuk ka qenë prezente në nënshkrimin e kësaj kontrate dhe rrjedhimisht nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi për shmangien fiskale që mund të kenë kryer bashkëpronarët e tjerë të nënës së saj, për aq kohë sa shumica e përfituar prej saj është e parashikuar në kontratë dhe për të është paguar tatimi përkatës. Qenia e subjektit në këtë veprim juridik vinte në radhë trashëgimie me zëvendësim, ndërkohë që dy shitësit e tjerë ishin pronarë të radhës së parë.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti ka deklaruar si çmim shitjeje atë të kontratës fillestare për shitje në një kohë të ardhme, ndërkohë është nënshkruar edhe një kontratë tjetër, ku subjekti i rivlerësimit ka qenë e përfaqësuar me prokurë ku çmimi është ndryshuar nga palët prezente. Komisioni vlerëson se ndryshimi i çmimit përbën pjesë në tagrin për ndryshimin e kontratës si një akt vullneti të përbashkët midis palëve. Megjithatë subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar ndryshimin e këtij çmimi, si një pjesë të burimit të kësaj pasurie, nuk ka asnjë dyshim se të ardhurat nga shitja e tokës kanë shërbyer për krijimin e depozitës bankare, dhe është kjo e fundit që ka shërbyer si një nga burimet e të ardhurave për apartamentin e prenotuar në vitin 2007.

Komisioni vlerëson se në rastin konkret nuk mund t'i atribuohet ndonjë sjellje për deklarim të pasaktë subjektit të rivlerësimit, për sa kohë mungon dashja dhe qëllimi për të kryer deklarim të pasaktë, deklarim të rremë apo fshehje pasurie. Nga të gjitha rrethanat faktike dhe nga hetimi administrativ, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë në dijeni, dhe rrjedhimisht, në mungesë të elementit të anës subjektive, ky ndryshim i çmimit nga një kontratë e mëpasshme nuk mund të konsiderohet si sjellje relevante për qëllim të zbatimit të ligjit nr. 84/2016.

iii. Hua në shumën 10.000 euro

Në deklaratën e pasurisë për vitin 2007 subjekti ka deklaruar se ka marrë hua me kontratën e huas me nr. *** rep., nr. *** kol., datë **27.12.2007**, në shumën 10.000 euro, personit tjetër të lidhur (babait të saj biologjik), z. M. G.

Në deklaratën e pasurisë për vitin 2009 subjekti ka deklaruar shlyerjen e plotë të huas me deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.11.2009.

¹⁵ Përllogaritur nga vlera 1.900.000 lekë/2.262 m² = 840 lekë/m².

Komisioni ka kryer hetim¹⁶ mbi burimin e ligjshëm të krijimit të të ardhurave të dhëna hua nga huadhënësi në shumën 10.000 euro. Nga hetimi ka rezultuar se:

- Me shkresën nr. *** prot., datë 25.10.2018, “Alpha Bank” ka informuar se shtetasi M. Z. G., (huadhënësi) ka llogari bankare në këtë bankë, duke na bashkëlidhur *statement* bankare të këtij shtetasi. Gjithashtu, nga kjo bankë informohemi se ky informacion i përket periudhës prej datës 2.3.2009 e në vijim, pasi platformat e mëparshme janë të paaksesueshme.
- Me shkresën nr. *** prot., datë 16.10.2018, “Raiffeisen Bank” ka informuar se shtetasi M. Z. G., ka: (a) llogari bankare në lekë me nr. *** me gjendje zero lekë; (b) depozitë kursimi me afat maturimi me datë 25.12.2018, në shumën 598.914 lekë; dhe (c) llogari në lekë me nr. ***, me gjendje zero lekë, për të investuar në Bono Thesari.
- Me shkresën nr. *** prot., datë 17.10.2018, “Raiffeisen Invest” ka informuar se shtetasi M. Z. G., ka pasur një marrëdhënie juridike me “Raiffeisen Invest” sh.a., duke qenë investor në *** në shumën 700.000 lekë, fond i cili është tërhequr në datën 18.8.2015.
- Me shkresën nr. *** prot., datë 15.10.2018, “Banka Amerikane e Investimeve” ka informuar se shtetasi M. G., është klient pranë “Bankës Amerikane të Investimeve” dhe aktualisht ka vetëm ID, por ka pasur një llogari kursimi në monedhën USD, e cila është hapur në datën 7.4.2003 dhe është mbyllur në datën 1.2.2010.
- Z. M. G., ka pasur një llogari në monedhën dollarë amerikan (USD) në “Alpha Bank”, të çelur në prill të vitit 2003, me gjendje shumën prej 5.000 USD, të cilat janë tërhequr tërësisht në muajin maj të vitit 2003. Më pas, në këtë llogari janë depozituar 10.437 USD, të cilat janë tërhequr plotësisht në shtator të vitit 2004. Pas këtij momenti për këtë shtetas nuk ka më të dhëna bankare deri në vitin 2007.

Sipas dokumentacionit të depozituar nga ZVRPP-ja Tiranë ka rezultuar se huadhënësi, me kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.6.2016, ka blerë së bashku me bashkëshorten pasuri të regjistruar në hipotekë, në shumën 42.000 euro, likuiduar tërësisht nëpërmjet kontratës së sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.1.2008, dhe deklaratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.6.2016, bashkëngjitur kontratës së sipërmarrjes.

Nga kontrata e sipërmarrjes rezulton se në momentin e nënshkrimit të saj (datë 9.1.2008), nga huadhënësi është paguar shuma 20.000 euro, ndërsa pjesa tjetër, sipas parashikimeve/akordimeve në kontratë, do të paguhej më tej në marrëveshje midis palëve.

Nga faktet rezulton se huaja 10.000 euro, i është dhënë subjektit të rivlerësimit në datën 27.12.2007. Kontrata e sipërmarrjes për blerjen e pasurisë nga huadhënësi është nënshkruar në datën 9.1.2008 kur është paguar edhe shuma 20.000 euro.

Lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave të huadhënësit për dhënien e huas në shumën 10.000 euro, subjekti ka sqaruar¹⁷ se *huaja në shumën prej 10.000 euro është dhënë në cash, dhe njëkohësisht mbi burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj huaje, duke vënë në dispozicion edhe dokumentacion provues si vijon:*

- Vërtetimin nr. *** prot., datë 7.2.2019, nga Drejtoria Rajonale e Institutit të Sigurimeve Shoqërore Tiranë, ku vërtetohet se z. M. G., është trajtuar me pension të parakohshëm dhe trajtohet me pension pleqërie suplementar dhe të ardhurat e përfituara nga pensionet në Sigurimet Shoqërore nga data e fillimit 1.1.1999 – 31.12.2018, janë në shumën 5.332.805 lekë.
- Vërtetimin nr. *** prot., datë 7.2.2019, nga Drejtoria Rajonale e Institutit të Sigurimeve Shoqërore Tiranës ku vërtetohet se znj. P. G., është trajtuar me pension të parakohshëm dhe trajtohet me pension pleqërie suplementar dhe të ardhurat e përfituara nga pensionet në Sigurimet Shoqërore nga data e fillimit 1.1.1999 – 31.12.2018, janë në shumën 5.587.339 lekë.
- Vërtetimin e datës 8.2.2019 nga “Alpha Bank” ku vërtetohet se z. M. G., është klient i kësaj banke dhe se në datën 4.10.2004 ka çelur pranë kësaj banke një llogari në monedhën USD dhe

¹⁶ Shkresa nr. *** prot., datë 12.10.2018, drejtuar “Bankës së Shqipërisë”, bankave të nivelit të dytë, si dhe institucioneve jobankare.

Shkresa nr. *** prot., datë 12.10.2018, drejtuar QKB-së.

Shkresa nr. *** prot., datë 12.10.2018, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Shkresa nr. *** prot., datë 12.10.2018, drejtuar ZVRPP-ve nëpër rrethe.

¹⁷ Referojuni përgjigjeve të pyetësorit nr. 3, datë 4.2.2019, dhe dokumentacionit bashkëngjitur, në dosjen e Komisionit.

ka lidhur një depozitë me afat njëmuor të rinovueshëm automatikisht në vlerën 15.000 USD, të cilën e ka tërhequr në datën 8.1.2008.

- Kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.11.2003, sipas të cilës znj. P. H. G., si palë shitëse, ka shitur pasurinë truall nr. *** e ndodhur në z.k. ***, në shumën 569.800 lekë, shumë kjo e cila është dorëzuar plotësisht jashtë zyrës noteriale.
- Kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.8.2010, sipas të cilës shtetasit M. G., dhe P. G., si palë shitëse, kanë shitur një apartament banimi me sip. 50 m², ndodhur në Pogradec, në shumën 2.302.900 lekë, shumë kjo e cila është likuiduar nga blerësi jashtë zyrës noteriale.
- Certifikatën e regjistrimit në organin tatimor të biznesit në emër të motrës biologjike të subjektit të rivlerësimit, znj. I. G., dhe vendimin e datës 17.1.2003 për çregjistrimin si person fizik privat të kërkueses I. G., për të mos ushtruar aktivitet privat.
- Një kopje të shkresës me nr. *** prot., datë 7.2.2019, nga “Raiffeisen Bank”, sipas të cilës znj. P. G., ka pasur disa llogari në Bankën e Kursimeve, të cilat janë mbyllur që në vitin 2004, dhe citohet se në kushtet kur kartelat e depozitave të Bankës së Kursimeve në momentin e shlyerjes/mbylljes janë lidhur me lidhjen ditore të kontabilitetit, ato janë asgjësuar pasi kanë pasur afat ruajtjeje 10 vjet nga koha e shlyerjes/mbylljes së tyre.
- Subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit një deklaratë noteriale me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 5.2.2019, sipas të cilës shtetasit M. G., dhe P. G., deklarojnë se janë bashkëshortë dhe prindërit biologjikë të znj. Regleta Panajoti (mbiemri përpara martesës, M., dhe mbiemri biologjik, G.) “... se në vitin 2007, nga të ardhurat që kishim nga shitja e një pasurie të llojit truall në adresën Korçë, nga shitja e pasurive të tjera të paluajtshme në qytetin e Pogradecit dhe të Korçës, të ardhurat nga aktiviteti tregtar, i kemi huazuar vajzës tonë një shumë prej 10.000 euro. Deklarojmë se shuma e dhënë hua, na është kthyer nga dhëndri dhe vajza në vitin 2009, shumë e cila shkoi për të blerë një apartament në qytetin e Tiranës.”

Referuar këtyre fakteve Komisioni vlerësoi t'i kërkojë subjektit të rivlerësimit informacion mbi mundësitë financiare të huadhënësit për kryerjen e shpenzimeve që rezultuan nga hetimi, duke përfshirë edhe blerjen e apartamentit nga huadhënësi, pasi nga analiza financiare e Komisionit ka rezultuar e paprovuar mundësia financiare e huadhënësit, për të mbuluar shpenzimet për dhënie e huas në shumën 10.000 euro, dhe njëkohësisht (pas dy javësh) të mund të paguante shumën 20.000 euro për porosinë e apartamentit, duke llogaritur si burim të ardhurash ato të deklaruara nga pensionet, si dhe shitja e pasurisë me sip. 814 m², në Korçë (pasuri kjo trashëgimore), në vlerën prej 569.800 lekësh sipas kontratës.

Subjektit iu kalua barra e provës në lidhje me këtë rezultat të hetimit.

Në shpjegimet e saj, subjekti ka sqaruar mundësitë financiare të babait të saj, z. M. G., duke vënë në dispozicion të Komisionit dokumente shtesë, si prova të reja.

Rezulton se në vitin 1996 prindërit biologjikë të subjektit kanë shitur banesën e tyre në qytetin e Pogradecit, në vlerën 1.800.000 lekë, nëpërmjet kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.6.1996, si dhe deklaratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.9.1996, të përfitimit të vlerës 1.800.000 lekë.

Subjekti, gjithashtu ka vënë në dispozicion të Komisionit edhe dokumentacion provues për të ardhurat e dy motrave të saj, I. G., dhe A. G., të cilat jetonin në këtë periudhë së bashku me prindërit.

Subjekti ka sqaruar se nëna biologjike ka qenë pronare e pasurisë me sip. 814 m², ndodhur në Korçë, pasuri kjo trashëgimore. Nga shitja e kësaj pasurie në vitin 2003 ajo ka përfituar një shumë prej 2.360.000 lekësh. Për këtë, subjekti ka vënë në dispozicion edhe një deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.6.2019, të blerësve të kësaj pasurie Sh., dhe G. M. Nga deklarimi i tyre nëpërmjet aktit noterial, në cilësinë e blerësve dhe të personave të palidhur me subjektin e rivlerësimit, rezulton se nëna e subjektit ka përfituar në vitin 2003 vlerën monetare prej 2.360.600 lekësh.

Arsyetimi ligjor

Nisur nga fakti se Komisioni nuk ka vlerësuar vetëm burimin e ligjshëm për të ardhurat e dhëna hua, por ka vlerësuar të hetojë edhe lidhur me burimin e të ardhurave që huadhënësi ka përdorur për blerjen e pronës, pas dy javësh, atëherë analiza duhet të bëhet e plotë dhe të merren në konsideratë të gjitha të ardhurat e huadhënësit.

Tabela e të ardhurave të pranuar nga Komisioni

Përshkrimi	Vitet 1999 - 2007
Të ardhura nga shitja e apartamentit në Pogradec	1.800.000
Të ardhura nga shitja e truallit me sip. 814 m ² ¹⁸	569.800
Të ardhura nga pensionet (1999 – 2007) ¹⁹	4.598.139
Shpenzime jetike (1999 – 2007)	3.036.582
Të ardhura nga dy motrat e subjektit, I. G., dhe A. G., të cilat jetonin në këtë periudhë së bashku me prindërit (Komisioni u gjet në pamundësi për të llogaritur vlerën e tyre për periudhën që i përket viteve 1999–2007 megjithëse rezultoi e provuar se ato kishin të ardhura)	0
Mundësia për të kursyer	3.931.173²⁰

Pas shqyrtimit të dokumentacionit, rezulton se huadhënësi z. M. G., ka pasur mundësi financiare me të ardhura nga burime të ligjshme për t'i dhënë vajzës së tij hua shumë 10.000 euro, por edhe për të paguar këstin e shtëpisë në vlerën 20.000 euro, dy javë më vonë.

Në përfundim, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti ka qenë i saktë në deklarinimin e saj dhe se huadhënësi ka pasur burime të ligjshme për dhënien e huas në shumë 10.000 euro.

15.5 Në vlerësimin tërësor të kësaj pasurie, Komisioni çmon se provat e paraqitura dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit kanë arritur nivelin e kërkuar të provueshmërisë dhe besueshmërisë. Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur, si dhe ata të tjerë të lidhur, kanë pasur mundësi financiare për krijimin e pasurisë objekt hetimi nga të ardhura të realizuara në mënyrë të ligjshme.

16. **Autoveturë tip “Scoda Octavia”**, viti i prodhimit 2009, blerë në vitin 2015, në vlerën 9.500 euro, me kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.5.2015.

16.1 Burimi i deklaruar i krijimit sipas deklaratës “Vetting”: kursime nga punësimi.

16.2 Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni rezulton se subjekti ka blerë autoveturën tip “Scoda Octavia”, viti i prodhimit 2009, me targë ***– me kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.5.2015 (noter M. P.), të pajisur me certifikatë pronësie të mjetit të datës 20.5.2015, ***. Vlera: 9.500 euro. Pjesa takuese: 1/2 për secilin nga bashkëshortët.

Me shkresën nr. *** prot., datë 5.7.2018, drejtuar DPSHTRR-së, është kërkuar informacion për çdo automjet që ka pasur apo ka në pronësi ose në përdorim subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të.

DPSHTRR-ja ka informuar se subjekti i rivlerësimit ka në pronësi mjetin me targë *** (në bashkëpronësi me personin e lidhur, z. S. P.) dhe ka pasur në pronësi mjetin me targë ***, deri në datën 13.11.2015, duke dërguar edhe dokumentacionin shoqërues.

Nga aktet rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj, me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.5.2015, kanë blerë nga shtetasi B. K., automjetin e markës “Scoda”, Tipi 1Z, me shasi ***, me targë ***, në shumë 9.500 euro, shumë e cila është dorëzuar nga blerësit në datën e nënshkrimit të kontratës. Pagesa e vlerës: 9.500 euro, ekuivalent me vlerën 1.339.405 lekë, është kryer në *cash*. Kjo pagesë është vërtetuar me mandatpagesën nr. ***, datë 14.5.2015.

¹⁸ Çmimi i llogaritur është ai sipas kontratës së shitjes.

¹⁹ Duke përpjesëtuar në mënyrë të barabartë sipas vërtetimit të ISSH-së të ardhurat për periudhën 1999 – 2018.

²⁰ Kursi i këmbimit 1 euro = 120.91 lekë. Afërsisht 32.513 euro.

Në datën 31.12.2014 gjendja e llogarive bankare për subjektin dhe personat e lidhur rezulton në shumën 5.434.824 lekë²¹.

Ndërkohë, gjendja e këtyre llogarive në datën 14.5.2015 është në shumën 5.040.284 lekë²².

Në mënyrë të detajuar analiza e të ardhurave dhe shpenzimeve paraqiten në tabelën më poshtë:

Periudha	1.1.2015 – 14.5.2015
Të ardhura nga paga, subjekti	546.334
Të ardhura nga paga, bashkëshorti i subjektit	800.000
Pakësim në llogarinë e bashkëshortit në "Tirana Bank"	663.272
Shpenzime jetese	- 214 286
Shpenzime për udhëtime	- 160 971
Blerje automjeti "SCODA" 9,500 €	-1.339 405
Diferenca (të ardhura - shpenzime)	294.944

16.3 Në përfundim të hetimit administrativ, pas shqyrtimit të dokumentacionit të administruar, bazuar në analizën financiare, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur mjaftueshëm burime të ligjshme për të justifikuar shumën e paguar për blerjen e këtij automjeti.

17. Shtëpi banimi dhe truall me sip. rreth 300 m² në fshatin ***, Gjirokastrë

Kjo pasuri është fituar në bazë të testamentit nr. ***, datë 5.10.2005, çelur me vendimin nr. ***, datë 29.4.2016, nga noter B. A., Gjirokastrë.

17.1 Burimi i krijimit: nëpërmjet trashëgimisë testamentare vetëm bashkëshortit. E pavlerësuar sipas çmimit të zonës ku ndodhet. Pjesa takuese: 50 %, vetëm bashkëshorti, z S. P.

17.2 Me shkresën nr. *** prot., datë 13.7.2018 drejtuar ZVRPP-së Gjirokastrë është kërkuar informacion dhe dokumentacion shoqërues mbi çdo pasuri të paluajtshme të regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të që prej origjinës dhe deri aktualisht, duke përfshirë edhe dokumentacion mbi rivlerësimin e pasurisë, nëse ka të tillë.

Në përgjigje të kërkesës, ZVRPP-ja Gjirokastrë²³ nuk ka konfirmuar pasuri në emër të personit të lidhur, bashkëshortit të subjektit.

Me shkresën nr. *** prot., datë 17.10.2018, drejtuar noterit publik, z. B. A., Gjirokastrë, është kërkuar informacion për këtë pronë.

Me shkresën nr. *** prot., datë 29.10.2018, noteri ka vënë në dispozicion praktikën e ndodhur në arkivin e tij personal. Nga dokumentacioni i depozituar prej noterit rezulton se me procesverbalin e datës 29.4.2016, me nr. *** është çelur testamenti i testatores Dh. P., nëna e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit. Kjo lidhje familjare konfirmohet nga certifikata e përbërjes familjare lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile, fshati ***, datë 2.4.2015. Në praktikën e noterit është administruar testamenti i datës 5.10.2005 i testatores Dh. P.

Në procesverbal është pasqyruar se testatorja ka ndërruar jetë më 11.8.2007 dhe se kishte lënë testamentin e tij nr. *** regjistri, datë 5.10.2005.

Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, me vendimin nr. ***, datë 29.4.2016, të noterit publik B. A. A., është njohur trashëgimtar testamentar për trashëgimlënësen testamentare Dh. P., për pasurinë e përshkruar pjesë takuese e tokës bujqësore të përfituar nga ligji nr. 7105, "Për tokën",

²¹ Llogari rrjedhëse e pagës së subjektit në "Credins Bank" në shumën 497.026 lekë; llogari rrjedhëse e pagës në "Credins Bank", djali i subjektit në shumën 17.058 lekë; depozitë në "Bankën Kombëtare Tregtare" në shumën 2.000.000 lekë; depozitë në "Tirana Bank" në lekë, bashkëshorti i subjektit, në shumën 2.000.000 lekë; llogari në "Tirana Bank" në lekë, djali i subjektit të rivlerësimit, në shumën 12.774 lekë; llogari në "Tirana Bank" në lekë, bashkëshorti i subjektit, në shumën 907.967 lekë.

²² Llogari rrjedhëse e pagës së subjektit në "Credins Bank" në shumën 745.870 lekë; llogari rrjedhëse e pagës në "Credins Bank", djali i subjektit në shumën 18.064 lekë; depozitë në "Bankën Kombëtare Tregtare" në lekë, në shumën 2.000.000 lekë; depozitë në "Tirana Bank" në lekë, bashkëshorti i subjektit, në shumën 2.000.000 lekë; llogari në "Tirana Bank" në lekë, djali i subjektit të rivlerësimit, në shumën 31.655 lekë; llogari në "Tirana Bank" në lekë, bashkëshorti i subjektit, në shumën 244.695 lekë.

²³ Sipas përgjigjes nr. *** prot., datë 26.7.2018, të ZVRPP-së Gjirokastrë në dosjen e Komisionit.

datë 19.7.1991, një vresht dhe një shtëpi banimi njëkatëshe, me bodrum poshtë dhe me oborr e kopsht rreth tij.

Subjekti, pasi është pyetur nëse kjo pasuri është regjistruar pas çeljes së dëshmisë testamentare²⁴, ndër të tjera, ka deklaruar: “... Konform deklaramëve të mëparshme, kjo pasuri është pasuri trashëgimore e fituar me çeljen e testamentit me vendimin nr. ***, datë 29.4.2016, për të cilën pas këtij momenti është aplikuar në datën 3.5.2016 për pajisje me certifikatë pronësie. Certifikata e pronësisë për këtë pasuri ka dalë në datën 27.4.2017, në regjistrat e ZVRPP-së Gjirokastrë, në bashkëpronësi me z. S. P., dhe z. M. P., (vëllai i bashkëshortit)”.

Gjithashtu, subjekti ka vënë në dispozicion një kopje të certifikatës së pronësisë nr. ***, datë 27.4.2017, të lëshuar nga ZVRPP-ja Gjirokastrë në datën 27.4.2017 dhe akteve të tjera të pronësisë, siç janë harta treguese e regjistrimit dhe kartela e pasurisë së paluajtshme.

17.3 Në përfundim, nuk rezultojnë paqartësi apo dyshime në lidhje me këtë pasuri. Ajo është një pasuri e ligjshme e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.

18. Truall me sipërfaqe 6340 m² me pjesë takuese 1/7, në *, Korçë**

18.1 Burimi i deklaruar i krijimit sipas deklaratës “Vetting”: nëpërmjet trashëgimisë ligjore dhe në rrugë gjyqësore, vendimi gjyqësor nr. ***, datë 9.6.2011, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Certifikatë pronësie datë 8.8.2010. E pavlerësuar sipas çmimit të zonës ku ndodhet. Pjesa takuese: 12/84 të sendit në bashkëpronësi.

18.3 Me shkresën nr. *** prot., datë 13.7.2018, drejtuar ZVRPP-së Korçë është kërkuar informacion dhe dokumentacion shoqëruar për çdo pasuri të paluajtshme të regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, që prej origjinës dhe deri aktualisht, duke përfshirë edhe dokumentacion mbi rivlerësimin e pasurisë, nëse ka të tillë.

ZVRPP-ja Korçë²⁵ ka informuar se Regleta P. (M.) figuron pronare me 12/84 pjesë të pandarë në pasurinë nr. ***, vol. ***, f. ***, z.k. *** (***) ; lloji i pasurisë: truall me sip. 6340 m².

Nga aktet rezulton se subjekti i rivlerësimit, me vendimin nr. ***, datë 29.2.2000 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me objekt *çelje dëshmi trashëgimie*, është trashëgimtare e vetme e trashëgimlënëses, nënës së tij, të ndjerës, S. M., në çdo të drejtë e detyrim që rrjedh prej tij. Në këto kushte, pasuria objekt i këtij hetimi administrativ është përfituar me dëshmi trashëgimie, konfirmuar kjo nga ZVRPP-ja Korçë, pasqyruar e regjistruar në kartelën e pasurisë me nr. pasurie ***, truall me sip. 6340 m², në pjesë takuese 12/84, në emër të subjektit të rivlerësimit, si dhe nga vendimi gjyqësor nr. ***, datë 9.6.2011, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, pas të cilit është lëshuar certifikatë pronësie në datën 8.8.2012²⁶.

18.4 Në përfundim nuk rezultojnë paqartësi apo dyshime në lidhje me këtë pasuri. Kjo është një pasuri e ligjshme e subjektit të rivlerësimit.

19. Truall me sip. 1130.4 m² dhe 1077.33 m², me pjesë takuese 1/7, *, Korçë**

19.1 Burimi i deklaruar i krijimit sipas deklaratës “Vetting”: fituar në rrugë trashëgimie ligjore dhe në rrugë gjyqësore, vendimi gjyqësor nr. ***, datë 6.11.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, i lënë në fuqi me vendimin nr. ***, datë 7.7.2010, të Gjykatës së Apelit Korçë. E pavlerësuar sipas çmimit të zonës ku ndodhet. Pjesa takuese: 12/84 të sendit në bashkëpronësi.

19.2 Me shkresën nr. *** prot., datë 13.7.2018, drejtuar ZVRPP-së Korçë, është kërkuar informacion dhe dokumentacion shoqëruar mbi çdo pasuri të paluajtshme të regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, që prej origjinës dhe deri aktualisht, duke përfshirë edhe dokumentacion mbi rivlerësimin e pasurisë, nëse ka të tillë.

²⁴ Referojuni përgjigjeve të pyetësorit nr. 3, datë 4.2.2019, në dosjen e Komisionit.

²⁵ Referojuni shkresës nr. *** prot., datë 13.7.2018, dhe dokumentacionin shoqëruar të ZVRPP-së Korçë në dosjen e Komisionit.

²⁶ Shihni aneksin ***në dosjen e ILDKPKI-së.

ZVRPP-ja Korçë²⁷ ka informuar se Regleta Panajoti (M.) figuron pronare me 12/84 pjesë të pandarë në pasurinë nr. ***, vol. ***, f. ***, z.k. *** (**); lloji i pasurisë: truall me sip. 1077.33 m².

Nga aktet e administruara rezulton se subjekti i rivlerësimit, me vendimin nr. ***, datë 29.2.2000 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me objekt *çelje dëshmi trashëgimie*, është trashëgimtare e vetme e trashëgimlënësës, nënës së tij, të ndjerës S. M., në çdo të drejtë e detyrim që rrjedh prej tij. Në këto kushte, pasuria objekt i këtij hetimi administrativ është përfituar me dëshmi trashëgimie, konfirmuar kjo nga ZVRPP-ja Korçë, pasqyruar e regjistruar në kartelën e pasurisë me nr. pasurie ***, truall me sip. 1077.33 m², në pjesë takuese 12/84 në emër të subjektit, si dhe nga vendimi gjyqësor nr. ***, datë 6.11.2009 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, lënë në fuqi pjesërisht me vendimin nr. ***, datë 7.7.2010 të Gjykatës së Apelit Korçë.²⁸

19.3 Në përfundim nuk rezultojnë paqartësi apo dyshime në lidhje me këtë pasuri. Kjo është një pasuri e ligjshme e subjektit të rivlerësimit.

20. Llogari bankare në “Tirana Bank”, me gjendje 16.010 euro

20.1 Burimi i deklaruar i krijimit sipas deklaratës “Vetting”: kursime ndër vite të bashkëshortëve.

20.2 Gjendja e kësaj llogarie është me prejardhje nga llogaria bankare në “Raiffeisen Bank” sh.a., hapur në datën 29.6.2015, në vlerën 2.000.000 lekë. Burimi i krijimit të këtij depozite janë fonde të ardhura nga “Tirana Bank” sh.a.

Me shkresën nr. *** prot., datë 5.7.2018 drejtuar “BKT”-së, është kërkuar informacion dhe dokumentacion shoqërues mbi transaksione financiare, çelje llogarie, depozita, kredi, *over draft*, garanci, kartë debiti etj., në emër të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të.

“BKT”-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 23.7.2018, ka informuar se shtetasit Regleta Panajoti, e datëlindjes 14.7.1972, dhe S. Ll. P., i datëlindjes 21.11.1962, në “BKT” kanë llogari depozite dyemërore me status aktiv, në monedhën lekë, me shumë të investuar: 2.035.763,45 lekë.

Sipas dokumenteve të administruar nga “Tirana Bank”, në llogarinë e pagës së bashkëshortit të subjektit, gjendja në këtë llogari në fillim të vitit 2010 ishte në vlerën 176.577 lekë, kurse gjendja në fund të vitit 2010 ishte në vlerën 1.154.816 lekë, tepriçë kjo e krijuar nga të ardhurat nga paga. Në datën 2.5.2011, nga teprica e mbartur në vitin 2010 dhe të ardhura të gjeneruara nga paga gjatë vitit 2011, bashkëshorti i subjektit kalon në depozitë kursimi shumë prej 1.000.000 lekësh.

Në datën 24.8.2011 kjo depozitë shtohet me 1.000.000 lekë të tjera, duke e çuar në 2.000.000 lekë gjendjen e kësaj depozite. Për këtë shtesë: (i) në datën 24.8.2011 është tërhequr shuma 700.000 nga llogaria e pagës së bashkëshortit të subjektit; dhe (ii) në datën 24.8.2011 rezulton të jetë tërhequr shuma 300.000 lekë nga llogaria e subjektit në “Credins Bank”.

Në datën 7.11.2011 kjo depozitë rezulton të jetë ulur me 1.000.000 lekë, duke e çuar gjendjen e saj në 1.015.655 lekë; gjendje e mbartur deri në fillim të vitit 2013.

Në datën 3.1.2013, nga gjendja në llogarinë e pagës së bashkëshortit të subjektit janë kaluar 957.000 lekë në depozitë, duke e çuar gjendjen e saj në 2.004.043 lekë; gjendje e mbartur deri në vitin 2015.

Në datën 29.6.2015, shuma prej 2.000.000 lekësh nga kjo depozitë kalon në llogari kursimi të subjektit të rivlerësimit në “Raiffeisen Bank”, shumë e cila, në datën 5.1.2017 tërhiqet dhe përdoret për depozitën e sipërcituar në euro në “Tirana Bank”.

20.3 Në përfundim të hetimit administrativ nga Komisioni nuk kanë rezultuar paqartësi apo dyshime mbi mundësinë e krijimit të këtij llogarie bankare, duke e konsideruar këtë një pasuri të ligjshme.

²⁷ Referojuni shkresës nr. *** prot., datë 13.7.2018, dhe dokumentacionin shoqërues të ZVRPP-së Korçë, në dosjen e Komisionit.

²⁸ Referojuni aneksit nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

21. Llogari bankare, “BKT” sh.a., datë 31.12.2014, me gjendje 2.027.189 lekë

21.1 Burimi i deklaruar i krijimit sipas deklaratës “Vetting”: kursime ndër vite të bashkëshortëve, nga viti i martësës 1994 e në vijim.

21.2 Nga dokumentacioni bankar rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti kanë çelur një llogari depozite dyemërore në “BKT” në nëntor të vitit 2011 në shumën 1.000.000 lekë. Kjo depozitë rezulton të jetë hapur me të ardhurat e tërhequra në “Tirana Bank” në datën 7.11.2011.

Më 30 dhjetor të vitit 2013 kjo depozitë është shtuar me 1.000.000 lekë të tjera, të cilat e kanë burimin nga tërheqja e kryer nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në datën 27.12.2013, në llogarinë e pagës. Në deklaratën periodike të vitit 2013, në lidhje me shtesën prej 1.000.000 lekësh, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim: kursime të vitit 2013, duke qenë i saktë në deklaram.

Arsyetimi ligjor

Nga hetimit ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë pasur mjaftueshëm burime të ligjshme financiare për të justifikuar shumat e depozituara në këtë llogari bankare.

Nga deklaramet e subjektit lidhur me burimin e krijimit të shumës prej 2.027.189 lekësh, të deklaruar në deklaratën “Vetting”, konstatohet se ai përsërit si burim shuma të cilat janë përdorur më parë si burim për pasuri të tjera, pa specifikuar saktësisht.

Gjatë hetimit administrativ të kryer, Komisioni ka zbritur burimet e përdorura në pasuri të tjera të shpjguara më lart dhe, në përfundim, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë pasur mundësitë financiare për të krijuar me të ardhura të përfutur në mënyrë të ligjshme këtë llogari.

Pasaktësitë e vërejtura në deklaramin e kësaj pasurie lidhur me burimin nuk u provua se kanë pasur për qëllim deklaram të rremë apo fshehje të kësaj llogarie bankare. Nga hetimi administrativ nuk rezultoi asnjë dyshim apo e dhënë që të përbente shkak në nivelin e kërkuar për ligjin nr. 84/2016.

22. Llogaritë bankare të personave të lidhur – djali dhe vajza e subjektit në deklaratën “Vetting”

- i. Llogari bankare në Holandë e djalit O. P., Banka “INBG” e hapur në vitin 2016, në vlerën rreth **5.500 euro**, në janar 2017.
- ii. Llogaria bankare në emër të vajzës, H. P., Banka “OCBC” në Singapor, hapur më 2016-n në vlerën rreth **100 euro**, në janar 2017.

Mbi këto deklarime subjektit i është kërkuar të depozitohë lëvizjet e llogarive bankare të lartpërmendura, prej momentit të çeljes, e deri aktualisht.

Subjekti ka sqaruar: “... megjithëse djali im, O. P., është larguar nga Holanda në korrik të vitit 2017 për të vazhduar studimet në Suedi dhe më pas për Intership në Bruksel, ka mundur të marrë printime të veprimeve të bankës së tij, të cilat i gjeni bashkëlidhur këtij pyetësori.”

“... lidhur me vajzën time, H. P., (e vitlindjes 1999), sqaroj se në vitin 2016 ajo ishte e mitur dhe në Singapor kjo moshë është deri në 21 vjeç. Shkolla e saj, *** Singapor, ka hapur llogarinë e saj bankare pranë bankës të deklaruar në formular. Kjo llogari aktualisht është e mbyllur. Edhe pas kontaktit elektronik të vajzës për t’u interesuar për informacion mbi llogarinë e mbyllur, i është bërë me dije se nuk mund të kalohen të dhënat e tij pa qenë prezent vajza... vajza ime i ka përfunduar në maj 2018 studimet e saj, ...nuk jeton më atje.”

22.1 Pas shqyrtimit të dokumentacionit të administruar nga Komisioni ka rezultuar se këto llogari bankare janë në përputhje me deklaramet e subjektit të rivlerësimit dhe nuk janë **konstatuar** mungesa burimesh financiare lidhur me gjendjen/depozitat në këto llogari bankare.

23. Në lidhje me deklaramin në deklaratën “Vetting” të llogarive bankare të pagës për subjektin e rivlerësimit dhe bashkëshortin.

- i. Në deklaratën “Vetting” subjekti i rivlerësimit deklaroi llogari page në “Credins Bank” sh.a., me gjendje në vlerën 496.000 lekë, në datën 19.1.2017.

ii. Në deklaratën “Vetting” bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit deklaroi llogari page në “Tirana Bank” sh.a., me gjendje në vlerën 778.857 lekë, në datën 19.1.2017.

Nga analizimi i strukturës së kreditimeve në llogari dhe akumulimi i gjendjes së deklaruar evidentohet se janë vetëm të ardhura nga pagat.

23.1 Këto llogari bankare rezultuan në përputhje me deklaratimet e subjektit të rivlerësimit. Nuk konstatohen mungesa burimesh financiare lidhur me këto llogari bankare.

24. Gjendje cash në vlerën 5.500 euro, jashtë institucioneve bankare, e deklaruar në deklaratën “Vetting”.

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar për herë të parë kursime *cash* në deklaratën periodike të vitit 2016, në shumën 3.500 euro.

Nga analiza financiare e kryer rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për të kursyer/krijuar këto likuiditete *cash* në shumën **3.500 euro**.

Në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar kursime *cash* në shumën **5.500 euro**, për rrjedhojë, shtesa në kursimet *cash* e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të tij deri në deklarin “Vetting” ka qenë në shumën **2.000 euro**. Rrjedhimisht, duket se subjekti, nga momenti i deklaratimit për vitin 2016, deri në deklarin “Vetting”, ka kursyer shumën 2.000 euro.

Nga verifikimi i lëvizjeve bankare rezultoi se pagat e muajit dhjetor janë derdhur për të dy bashkëshortët përpara depozitimit të deklaratës “Vetting”, përkatësisht, subjektit të rivlerësimit i është kredituar shuma prej 107.753 lekësh dhe bashkëshortit shuma prej 100.000 lekësh. Shpenzimet për jetesë të përllogaritura deri në deklaratën “Vetting” janë në shumën prej afro 53.000 lekësh, ndërsa të ardhurat në total rezultojnë në shumën 207.753 lekë.

Nga verifikimi i veprimeve bankare rezultoi që nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i tij janë tërhequr *cash* në ATM në periudhën 1.1.2017 – 25.1.2017, gjithsej 200.000 lekë.

Në këto kushte, mundësia për të kursyer për këtë periudhë²⁹ është në shumën 154.753 lekë ose, e konvertuar në 1.160 euro, sipas kursit mesatar të këmbimit të fundvitit 2016 të “Bankës së Shqipërisë” të fundit të vitit 2016. Shuma maksimale e kursyer do të mund të ishte 3.500 euro + 1.160 euro = 4.660 euro, pra, rezultoi një mangësi në vlerën 840 euro.

Për këtë subjektin iu kalua barra e provës.

Së bashku me shpjegimet, subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit kontratën e shitblerjes së automjetit me nr. *** rep., nr. *** kol., në datën 19.10.2015, me vlerë 2000 euro, shumë kjo e deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2015.

Vetë subjekti ka arsyetuar se kursimet e deklaruara në deklaratën vjetore 2016 janë *shtesë* në kursimet e tyre familjare, për sa i përket gjendjes *cash* në banesë, ndaj këto dy vlera të mbledhura kanë sjellë deklarin e gjendjes në shumën 5500 euro në deklaratën “Vetting”.

24.1 Nga hetimi administrativ nuk pati të dhëna që të ngrinin dyshime për fshehje apo deklarime të rreme, lidhur me shumën e deklaruar 5500 euro, si gjendje *cash* në banesë.

Në vlerësim të këtyre fakteve, Komisioni del në përfundimin se subjekti ka qenë korrekt në deklarin e tij në deklaratat përkatëse ndër vite dhe në atë “Vetting” dhe i ka pasur aftësitë financiare për të krijuar gjendjen *cash* në shumë të deklaruar.

25. Shuma 12.000 euro, depozituar/disponuar nga subjekti në vitin 2007 në “Tirana Bank”.

Në deklaratën për vitin 2007 subjekti ka deklaruar një transaksion bankar, por pa e pasqyruar shumën që ishte depozituar në “Tirana Bank”, në shkurt të vitit 2007 dhe që ishte tërhequr në tetor të po këtij viti në nr. e llogarisë ***, të deklaruar 50 % me bashkëshortin.

²⁹ Në periudhën 1.1.2017 – 25.1.2017, e cila është data e dorëzimit të deklaratës “Vetting”.

Për sa më lart, subjekti është pyetur lidhur me këtë konstatim të Komisionit, si dhe me burimin e krijimit të depozitës, i cili në përgjigjen e dhënë ka sqaruar: “...Shuma e depozituar në këtë bankë në vitin 2007 ka qenë në vlerën 12.000 euro, të cilat janë depozituar në shkurt 2007 dhe janë tërhequr në tetor 2007. Në këtë periudhë kjo shumë ka qenë një pjesë e diferencës së vlerave tona monetare të mbetura nga kursimet nga punësimi deri në këtë datë, vlera monetare të kursyera që dispononim në cash në familje, vlera të përfituara nga shitja e tokës në Korçë në vitin 2003, vlera e përfitur nga shpronësimi publik në vitin 2001, etj.

Në dokumentacionin e “Vetting”-ut unë kam depozituar edhe librezën e asaj kohe dhe vazhdimësinë e kësaj llogarie bankare me ndryshimin e saj. Bashkë me formularët periodikë dhe ato të “Vetting”-ut, unë kam depozituar bashkëlidhur çdo vit edhe vërtetimin për të ardhurat e nxjerra nga punësimi ynë deri në këtë vit... Dokumentacioni justifikues është kryesisht dokumentacioni i të ardhurave që është depozituar në deklaratimet periodike pranë ILDKPKI-së dhe bashkëngjitur deklaratës “Vetting” në formën e vërtetimeve për të ardhurat nga paga, aktet për vlerën e përfitur nga shitja e tokës në vitin 2003 në Korçë (bashkëngjitur), dokumentacioni shpronësimi për interes publik në vitin 2001, dorëzuar me deklaratën ‘Vetting’”

Subjekti ka vënë në dispozicion një vërtetim (tabelë financiare) të datës 5.11.2018 të lëshuar nga punëdhënësi – shoqëria “****” sh.p.k. – mbi të ardhurat nga punësimi i bashkëshortit të subjektit – z. S. P., – nga viti 2004, e në vijim për çdo vit.

Nga analizimi i llogarive bankare rezulton se në datën 4.1.2007 bashkëshorti i subjektit ka tërhequr nga llogaria e pagës në “Tirana Bank” shumën 500.000 lekë dhe, në vijimësi, deri në datën e kësaj derdhjeje, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti kanë tërhequr në ATM edhe shumën 132.874 lekë.

Duke shqyrtuar sqarimet e subjektit, konstatohet se ka përmendur si burim të ardhurat nga shpronësimi dhe nga shitja e tokës në Korçë, të ardhura që në fakt janë përdorur përkatësisht në blerjen e apartamentit në vitin 2002, si dhe për krijimin e depozitës në shumën 20.000 USD. Në këto kushte, ky burim nuk mund të merret parasysh.

Në fund të vitit 2006 subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar kursime cash, ndërkohë që ka depozituar shumën 12.000 euro në shkurt të vitit 2007³⁰ dhe e ka tërhequr atë në tetor të po këtij viti.

Duke konsideruar sikur të gjitha tërheqjet e kryera në bankë (arkë dhe ATM) të kenë shkuar për krijimin e kësaj shume, ato do të kontribuonin me 632.874 lekë. Referuar kursit zyrtar të “Bankës së Shqipërisë” në datën 23.2.2007, vlera 12.000 euro do të ishte ekuivalent me vlerën 1.503.720 lekë. Pra, diferenca do të ishte $1.503.720 - 632.847 = 870.873$ lekë.

Për këtë rezultat të hetimit subjektit iu kalua barra e provës, me arsyetimin se në periudhën janar – shkurt të vitit 2007 nuk ka pasur mjaftueshëm burime të ligjshme për krijimin e shumës 870.873 lekë.

Subjekti ka sqaruar se depozita në “Tirana Bank” rezulton të jetë hapur në datën 21.2.2007 dhe është mbyllur në datën 2.10.2007, për vlerën 12.000 euro.

Sipas shpjegimeve të tij: “...kjo depozitë ka pikërisht si burim të tij analizën financiare për të ardhurat tona ndër vitet 2002 – 2006 ku rezultojnë se ne, jo vetëm kemi pasur mundësinë të paguajmë këstin e pasurisë nr. 2 në tetor të vitit 2007 (vlera 30.000 euro), por të depozitojmë edhe vlerën 12.000 euro nga vlera e kursyer nga puna. Deri në fund të vitit 2006 (periudha 2002 – 2006) të ardhurat vetëm nga punësimi ynë rezultojnë në vlera monetare 9.398.814 lekë. Nga kjo vlerë zbrësim shpenzimet e llogaritura nga ana juaj (2002 – 2006) në vlerën 3.361.054 lekë. Diferenca midis këtyre dy vlerave rezulton 6.037.760 lekë (fitimi ynë neto për këtë periudhë). Kjo vlerë e konvertuar me kursin e euros në vitin 2006, sipas analizës suaj financiare, rezulton në shumën 48.808 euro. Kjo shumë mbulon rreth 4 herë depozitën prej 12.000 eurosh të përdorur për hapjen e llogarisë bankare në “Tirana Bank” sh.a. në shkurt të vitit 2007.”

³⁰ 23 shkurt 2007.

Arsyetimi ligjor

Pas shpjegimeve të subjektit dhe vlerësimit të fakteve dhe të provave të mbledhura gjatë hetimit Komisioni konstaton se subjekti nuk ka deklaruar gjendje *cash* në deklaratimet periodike vjetore, megjithëse pretendimi i tij për të ardhura të mjaftueshme që të përballojnë këto shpenzime qëndron.

Mosdeklarimi i gjendjes *cash* për vitin 2006 nuk krijon mundësitë financiare për depozitimin e shumës 12.000 euro në datën 21.2.2007, duke krijuar një pamundësi në vlerën **870.873 lekë**. Pavarësisht të ardhurave të konsiderueshme të krijuara nga subjekti dhe bashkëshorti i tij, të dokumentuara, nuk ka një element provues të kursimeve gjendje *cash* në banesë nga viti 2006.

Komisioni vlerësoi shpjegimet e subjektit: (1) lidhur me pretendimet për deklarimin e gjendjes *cash* në banesë, e cila arsyeton se në kuptim të ligjit për Deklarimin e Pasurive ata nuk kanë kuptuar se kanë pasur detyrimin të deklarorë edhe gjendjen e *cash*-it në banesë. Subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar se ky keqkuptim nuk është i qëllimshëm dhe se shumë subjekte të tjera rivlerësimi e kanë kuptuar ligjin në të njëjtën mënyrë me të. (2) si dhe ato lidhur me të ardhurat e bashkëshortëve në këto vite, të cilat ishin disa herë më të larta se shpenzimet e kryera dhe të dokumentuara.

Nga vlerësimi i dokumentacionit ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit vërtet nuk ka deklaruar gjendjen *cash* në banesë deri në vitet 2015 por se të ardhurat e tyre të ligjshme kanë qenë realisht dy deri në tri herë më të larta se shpenzimet e deklaruara.

Në përfundim të analizës, Komisioni çmon se pavarësisht mundësisë reale që subjekti ka pasur për realizimin e këtyre të ardhurave, mosdeklarimi i gjendjes *cash* në banesë nuk mund të provojë me saktësi se kemi të bëjmë me pasaktësi në deklarim apo me mungesë burimesh financiare të ligjshme.

Por, bazuar në të gjitha rrethanat faktike dhe nga hetimi administrativ, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi financiare për krijimin e kësaj pasurie dhe se nuk ka pasur qëllimin dhe dashjen për të bërë deklarim të pasaktë, deklarim të rremë apo fshehje pasurie. Ky përfundim arrihet bazuar edhe në faktin se shuma objekt verifikimi ka qenë e depozituar në bankë në emër të subjektit dhe nuk u konstatuan veprime të qëllimshme nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të. Rrjedhimisht, në mungesë të elementit të anës subjektive, kursimi nga burime të ligjshme i një shume parash jashtë sistemit bankar në vitin 2007, duke pasur parasysh edhe kalimin e një kohe të gjatë, si edhe mundësitë reale të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit për të krijuar këto të ardhura, nuk mund të konsiderohet si sjellje që përbën shkak relevant për qëllim të zbatimit të ligjit nr. 84/2016 dhe marrjen e një mase disiplinore.

25.1 Në përfundim, në vlerësimin tërësor të komponentit të pasurisë, Komisioni çmoi se për shkak të peshës së ulët specifike, në raport dhe në proporcion me të gjitha faktet, rrethanat dhe provat e grumbulluara gjatë hetimit administrativ në lidhje me këtë kriter të vlerësimit, ky konstatim nuk mund të përbëjë shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit. Pasaktësia në deklarimin e gjendjes *cash* nuk mund të jetë shkak i mjaftueshëm për të provuar mungesën e të ardhurave, mbështetur edhe në faktin se aftësitë financiare për t'i pasur vërtetohen nga dokumentacioni i administruar.

Konkluzion përfundimtar mbi vlerësimin e pasurisë së subjektit

Pasi u hetua në mënyrë të thelluar mbi të ardhurat, shpenzimet dhe pasuritë e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, Komisioni çmon se parregullsitë formale, të konstatuara në deklaratime apo dukja e mungesës së të ardhurave në momente të caktuara përgjatë deklaratimeve të pasurisë ndër vite, nuk ka pasur për qëllim fshehjen apo paraqitjen në mënyrë të pasaktë të pasurisë. Nisur nga rrethanat konkrete, bashkëpunimi i subjektit të rivlerësimit dhe gatishmëria e tij për të vënë në dispozicion me vërtetësi informacionin e kërkuar, Komisioni vlerëson se parregullsitë formale të konstatuara dhe mungesa e burimit të ligjshëm për shumën prej 870.873 lekësh nuk janë si shkak i mjaftueshëm që plotëson nivelin e kërkuar për qëllim të zbatimit të ligjit

nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Duke arsyetuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, duke vënë në balancë vlerën e këtyre pasaktësive formale, në raport me provat e tjera të administruara nga Komisioni, nëpërmjet hetimit të tij, Komisioni konstaton se subjekti ka arritur të argumentojë burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave të veta, si detyrimi kryesor kushtetues i tij.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Regleta Panajoti, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

B. VLERËSIMI I FIGURËS

26. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit. Për këtë qëllim, për subjektin e rivlerësimit është përcjellë raporti nr. *** prot., datë 31.10.2017, në përputhje me nenin 39, të ligjit nr. 84/2016, ku konstatohet: “Përshtatshmëria për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, znj. Regleta Panajoti (G./M.)”. Ky raport është deklasifikuar³¹ në datën 20.7.2018.

Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

27. Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni nuk u gjetën elemente lidhur me problematika të mundshme mbi figurën apo që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Në përfundim, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit ka një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës dhe se është në kushtet e përshtatshmërisë për vazhdimin e detyrës si gjyqtare.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

28. **Vlerësimi i aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Regleta Panajoti,** është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin: (1) e raportit për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer nga Grupi i Punës i ngritur pranë Inspektoratit të KLD-së, dërguar me shkresën nr. *** prot., datë 1.11.2018; (2) i vlerësimit të ankesave të subjekteve denoncuese; (3) i kritereve të vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

29. Në raportit për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, Regleta Panajoti, të përgatitur nga Inspektorati i KLD-së lidhur me aftësitë profesionale është vërejtur se subjekti i rivlerësimit ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe të zbatimit të ligjit. Identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të tij në rastin konkret. Shprehet në çdo rast me urdhra dhe vendime të ndërmjetme të arsyetuara. Njeh parimet e përgjithshme të së drejtës dhe i zbaton ato gjatë gjykimit, por nuk i përdor shprehimisht në tekstin e vendimeve përfundimtare.

Vendimet gjyqësore të hartuara nga subjekti i rivlerësimit, znj. Regleta Panajoti, janë të kuptueshme dhe të argumentuara. Niveli i arsyetimit të vendimeve ligjore të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor.

Nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short u konstatua se përgjithësisht ato kanë qenë të rregullta, të sakta dhe të plota. Në të gjitha rastet janë mbajtur procesverbalet administrative për të pasqyruar rastet e mungesës së gjyqtarës dhe njoftimin e palëve ndërgjyqëse

³¹ Vendim nr. ***, datë 20.7.2018.

për seancën vijuese. Në dosje gjenden të gjitha aktet e procesit gjyqësor të zhvilluar, kërkesëpaditë, procesverbalet, kërkesa penale, procesverbale të seancave përgatitore apo gjyqësore etj.

Në pesë dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor është konstatuar se gjyqtarja Regleta Panajoti komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse, qoftë në seancat përgatitore, qoftë në seancat gjyqësore. Ajo ka aftësi komunikuese me palët ndërgjyqëse gjatë veprimtarisë përgatitore dhe gjyqësore, duke shfaqur sjellje etike, si dhe duke ruajtur paanësinë në gjykim dhe duke respektuar barazinë e palëve. Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara, gjuha e përdorur në akte është normale dhe komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë.

❖ TË DHËNA NGA BURIME ARKIVORE TË KLD-SË

30. Nga analiza e të dhënave në dosjen personale, konstatohet se gjyqtarja Regleta Panajoti ka marrë titullin “Jurist” nga Universiteti i Tiranës në datën 30.6.1994. Në datën 13.5.2000 është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Sipas regjistrimit të ankesave, nga 8 tetor 2013 deri në 8 tetor 2016, ndaj subjektit janë depozituar katër ankesa në KLD, përkatësisht një për vitin 2013, një për vitin 2014 dhe dy ankesa për vitin 2016. Dy ankesat e para janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar, me arsyetimin se pretendimet mund të zgjidhen përmes apelimit gjyqësor, ndërsa për dy ankesat e tjera për vitin 2016, njëra është arkivuar pasi pretendimet kanë rezultuar pas verifikimit se ishin të pabazuara dhe ankesa tjetër, po për këtë vit, pasi është verifikuar për zvarritje gjykimi, i është regjistruar gjyqtares për vlerësim profesional dhe etik, sepse është konstatuar vonesë për dy vjet e katër muaj në gjykimin e çështjes.

Pas kërimit të informacionit nga Komisioni, KLD-ja³² ka informuar se prej vitit 2006 e në vijim për subjektin e rivlerësimit, znj. Regleta Panajoti, nuk ka pasur asnjë kërkesë/propozim të ardhur nga Ministri i Drejtësisë për procedim disiplinor; për pasojë, nuk rezulton të jetë propozuar apo marrë ndonjë masë disiplinore.

✓ NË LIDHJE ME DENONCIMET

31. Pranë Komisionit janë paraqitur 11 denoncime të publikut për subjektin e rivlerësimit. Lidhur me këto denoncime subjekti paraqiti shpjegime në përgjigje të rezultateve të hetimit.

Komisioni, në bazë të nenit 53, të ligjit nr. 84/2016, i vlerësoi denoncimet e paraqitura dhe konstatoi se dy prej tyre përmbajnë shkaqe të mjaftueshme për verifikim:

1. **Dosja që i përket çështjes civile për pjesëtim të pasurisë nr. *****. Nga dokumentacioni i depozituar nga denoncuesi rezulton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. *** akti, datë 19.1.2009, “Faza e parë e pjesëtimit të pasurisë”, të gjyqtares Regleta Panajoti dhe të dy anëtarëve të tjerë të trupës gjyqësore ka vendosur: *lejimin e pjesëtimit të pasurisë së paluajtshme... duke përcaktuar edhe pjesët takuese për secilin bashkëpronar, ku bën pjesë edhe z. Sh., aktualisht me cilësinë e denoncuesit.*

Sipas pretendimeve të denoncuesit, rezulton se çështja është ankimuar në të tria shkallët e gjyqësorit dhe se Gjykata e Lartë ka konstatuar mangësi në veprimtarinë e administrimit dhe të vlerësimit të provave, si dhe të shqyrtimit të çështjes nga subjekti.

Subjekti i rivlerësimit të shpjegimet e tij sqaron:

*“Rezulton se me vendimin nr. *** akti, datë 19.1.2009 (ku subjekti, Regleta Panajoti, ka qenë kryesues i trupës gjyqësore) është zgjidhur faza e parë e pjesëtimit të sendit në bashkëpronësi. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. ***, datë 8.09.2009, të Gjykatës së Apelit Tiranë. Rezulton se Gjykata e Lartë, me vendimin nr. ***, datë 17.10.2013, e ka prishur vendimin nr. ***, datë 8.9.2009 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe e ka kthyer çështjen për rigjykim po në Gjykatën e Apelit Tiranë.*

³² Referojuni shkresës nr. *** prot., datë 10.7.2018, në dosjen e Komisionit.

*Rezulton se Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 9.9.2014, në rigjykimin e çështjes ka vendosur: lënien në fuqi të vendimit nr. *** akti, datë 19.1.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.*

*Gjykata e Lartë, me vendimin nr. ***, datë 23.9.2016 ka vendosur”. “Mospranimin e rekursit të paraqitur nga i padituri S. Sh., kundër vendimit nr. ***, datë 9.9.2014 të Gjykatës së Apelit Tiranë”.*

*Rezulton se me vendimin nr. ***, datë 24.11.2017, Gjykata (ku kryesues i trupës gjyqësore ka qenë subjekti, Regleta Panajoti) ka përfunduar gjykimin e fazës së dytë të pjesëtimit të pasurisë. Subjekti i rivlerësimit ka bashkëlidhur si provë kopje të vendimeve gjyqësore të cituara më lart.”*

Nga vlerësimi i tërësisë së vendimmarrjeve, rezultoi se vendimi i shpallur nga subjekti i vlerësimit, Regleta Panajoti, nuk është cenuar nga asnjë shkallë e gjyqësorit, si nga Gjykata e Apelit (në të dyja herët e gjykimin në këtë gjykatë vendimi është lënë në fuqi), **por edhe nga Gjykata e Lartë**, ku në përfundim rezulton të mos jetë cenuar vendimi i shpallur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Edhe arsyetimi i vendimit nr. ***, datë 17.10.2013, i Gjykatës së Lartë (që ka prishur vendimin nr. ***, datë 8.9.2009 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe ka kthyer çështjen po në Gjykatën e Apelit Tiranë për rigjykim), nuk konstaton problematika procedurale apo ligjore që mund të cenonin vendimmarrjet si më lart cituar nga denoncuesi, ndaj dhe e ka lënë të pacenuar vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, (referuar arsyetimit pika 12.1-13.1 të vendimit).

Nga vlerësimi i fakteve dhe i dokumentacionit të administruar, u vlerësua se ky denoncim nuk ka elemente të besueshme, të cilat mund të cenonin punën dhe aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit.

2. Dosja që i përket çështjes civile nr. *. për pavlefshmëri kontrate.** Denoncuesi A. M., ankohet për shkelje procedurale; mosrespektim afatesh; vendime të ndërmjetme kontradiktore, të njëanshme dhe joligjore; për një vendim përfundimtar të padrejtë të bazuar në një aktekspertizë, që kundërshton dy ekspertiza të mëparshme (të injoruara qëllimisht nga gjyqtarja – sipas tij).

Lidhur me këtë çështje nga verifikimi konstatohet se Vendimi gjyqësor rezulton të jete në proces shqyrtimi në Gjykatën e Apelit Tiranë, ndaj ky denoncim nuk mund të jetë objekt shqyrtimi nga Komisioni.

31.1 Në **përfundim**, nga vlerësimi i denoncimeve, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe dokumentacioni i administruar në dosje, Komisioni konstaton se nuk u gjetën fakte të besueshme, të cilat mund të cenonin punën dhe aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit në kuptim të pikës 4, të nenit 43, të ligjit nr. 84/2016. Denoncimet e analizuar nuk ngritën dyshime të arsyeshme për veprime korruptuese të kryera nga subjekti i rivlerësimit apo në bashkëpunim me persona të tjerë.

Konkluzione për rubrikën e vlerësimit profesional

Trupi gjykues vlerëson se në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të mira në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve dhe konsiderohet “i aftë”.

Trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

D. KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe të vlerësimit objektiv, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale,

PËR KËTO ARSYE

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të germës “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit e rivlerësimit, znj. Regleta Panajoti, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Vendimi i arsyetuar, me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose subjekti i rivlerësimit, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
4. Ky vendim u shpall në Tiranë, më 26.6.2019.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

GENTA TAFI (BUNGO)

Kryesuese

VALBONA SANXHAKTARI

Anëtare

LULZIM HAMITAJ

Relator/ kundër

Sekretare gjyqësore
Anisa Duka

MENDIM PAKICE

Unë, komisioner Lulzim Hamitaj, si anëtar i trupit gjykues, nuk pajtohem me vendimin e marrë nga koleget e shumicës, për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Regleta Panajoti, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për shkak se subjekti i rivlerësimit, sipas meje, nuk arriti një nivel të besueshëm në rivlerësimin e pasurisë. Ndërsa, në lidhje me kriterin e figurës dhe me atë të aftësive profesionale, si dhe me pikat e tjera të rivlerësimit të kriterit të pasurisë që nuk do të analizohen në vijim, bashkohem me mendimin e shumicës së trupit gjykues.

Unë, si anëtar në pakicë/kundër vlerësoj se subjekti i rivlerësimit nuk duhet të ishte konfirmuar në detyrë, duke mos arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, pasi nga hetimi administrativ, i kryer nga Komisioni, ka rezultuar se znj. Regleta Panajoti:

- A. Ka pasur mungesë në vlerën prej 3.8 milionë lekësh të burimeve të ligjshme financiare – sipas parashikimeve të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 84/2016, të ndërthurura edhe me jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit – për të justifikuar të gjitha investimet, shpenzimet dhe kursimet e deklaruara, si dhe mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën prej 870.873 lekësh, për t'i mundësuar subjektit disponimin dhe depozitimin e shumës prej 12.000 euro në shkurt të vitit 2007.
- B. Ka kryer një sërë deklarimesh të pamjaftueshme ndër vite, në kundërshtim me ligjin nr. 9049/2003, të ndryshuar – pasi nuk ka përmbushur detyrimin ligjor për të deklaruar në ILDKPKI shumat monetare të mbajtura në gjendje *cash*, në banesë, dhe të mbartura nga njëri vit në tjetrin.
- C. Ka kryer deklaram të pamjaftueshëm në deklaratën “Vetting”, duke përshkruar një të ardhur nga shitja e një pasurie, më të lartë nga sa rezulton çmimi në kontratën respektive, ose ka nënshkruar një kontratë fiktive, lidhur me shitjen e një pasurie të paluajtshme, pasi – sipas subjektit – në kontratë është pasqyruar/përshkruar një çmim i ndryshëm shitblerjeje, më i ulët nga ai që realisht ishte negociuar nga palët (përfituara nga subjekti) dhe ishte paguar nga pala blerëse, duke evituar në këtë mënyrë pagesën e plotë të taksave nga subjekti mbi fitimin e shtuar, si dhe duke favorizuar pagesën e një takse më të ulët nga blerësi për regjistrimin e pasurisë (objekt i kontratës në fjalë), në emër të këtij të fundit. Gjithashtu, ndër vite, ka kryer deklarime të pasakta dhe kontradiktore, duke përshkruar të njëjtin burim financiar për më shumë se një pasuri.

A. Lidhur me mungesën e burimeve të ligjshme financiare ndër vite

A.1 Analiza e burimit të krijimit të pasurisë apartament banimi – me sipërfaqe 104.23 m² ndodhur në “***”, Tiranë, blerë me kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 11.1.2002, në vlerën 47.150 USD – **të deklaruar nga subjekti në deklaratën “Vetting”**: “... të ardhurat e përfituara nga emigracioni ekonomik/punësimi në Greqi; aktiviteti tregtar i bashkëshortit; shpronësimi për interes publik dhe punësimi i bashkëshortëve.”

A.1.1 Puna nga emigracioni ekonomik dhe punësimi në Greqi

- i. Në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar të ardhura të përfituara nga emigracioni sezonal në periudhën 1991 – 2004 dhe nga emigracioni i plotë në vitet 1995 – 1996 në Greqi.

- ii. Në mbështetje të këtij deklarami/pretendimi, subjekti ka depozituar, në cilësinë e provës, fotokopje të pasaportës së Republikës së Shqipërisë të personit të lidhur – bashkëshortit të saj, z. S. P. – me datë lëshimi 14.6.1995, me vizë greke të lëshuar në datën 22.1.1997 – 14.6.2000, si dhe fotokopje të pasaportës së Republikës së Shqipërisë së subjektit të rivlerësimit, me viza greke të lëshuara në datat 17.7.1997 – 16.10.97, datë. 4.3.1998 – 3.3.1999, datë 23.3.1991 – 22.9.2000, etj.
- iii. Në deklaratën “Vetting”, në rubrikën e të ardhurave, është deklaruar se nga puna në emigracion është realizuar një përfitim në vlerën prej 3.500.000 lekësh, të sjella periodikisht në *cash* nga Greqia dhe të konvertuara nga *dhrahmi* në lekë.
- iv. Përveç dokumenteve të udhëtimit, si më lart – nga ku nuk rezultojnë periudha të gjata qëndrimi në Greqi, (sezonale apo vjetore qofshin ato) – subjekti nuk kishte vënë në dispozicion dokumente të tjera për të provuar burimin e ligjshëm të krijimit të të ardhurave nga emigracioni ekonomik në shtetin grek.
- v. Lidhur me paqartësitë e deklaruara në deklaratën “Vetting”, për sa i përket periudhave kohore të punësimit në emigracion me kohë të plotë apo të pjesshme, pasi ato ndikonin në analizën financiare për një hetim të thelluar, me qëllim saktësimin e deklarimeve të bëra, është pyetur subjekti, i cili ka sqaruar¹ se: “... *punësimi jonë periodik në emigracion ka qenë në vitet 1991 – 1994 ku unë kam punuar në punë sezonale 3-4 muaj çdo vit në verë në Greqi, dhe bashkëshorti im, pas vitit 1990 ka punuar gjatë gjithë kësaj periudhe në Greqi duke u shkëputur edhe pa të drejtë page nga puna në Shqipëri etj.*”
- vi. Sipas dokumentit të udhëtimit të të dy bashkëshortëve rezultojnë hyrje-dalje në shtetin grek në afate tepër të shkurtra që fillojnë nga dy ditë, një javë, apo dy javë, përkatësisht, udhëtime të kryera nga bashkëshorti i subjektit në vitin 1999 dhe nga subjekti në vitin 1996, 1997, 2000 dhe 2002 (gjithnjë brenda mundësive sa mund të vërehen hyrje-daljet në fletët e kopjeve të pasaportave të depozituara). Këto janë të vetmet dokumente të cilët subjekti i disponon dhe përdor për justifikim si burim i ligjshëm i përfitimit të të ardhurave të punës në emigracion.
- vii. Pasi i kaloi barra e provës lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave në vlerën prej 3.820.219 lekësh, që ishin konstatuar nga Komisioni si mungesë financiare për blerjen e pasurisë në fjalë, subjekti i rivlerësimit, lidhur me të ardhurat nga emigracioni, ka paraqitur:
 - a. “Certifikatë e regjistrimit të një personi të siguar drejtpërdrejtë”, të lëshuar nga institucioni përgjegjës për punësimin në Greqi, nga e cila rezulton se z. S. P. është deklaruar si i punësuar që në datën 16.10.1995 dhe po kështu, njoftohen punëdhënësit e tij për të dhënat e personit të siguar, si dhe detyrimin për ta siguar z. S. P.
 - b. Në seancën dëgjimore, subjekti ka depozituar gjithashtu edhe “Libër shëndeti fëmije” për djalë të saj, O. P., i datëlindjes 10.6.1995, lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë Greqi. Nga përmbajtja e përkthyer rezulton se vendbanimi i subjektit dhe familjes së saj në vitin 1995 është ***, Greqi. Bazuar në kuadrin ligjor të Republikës së Greqisë, rezulton se të siguarit pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore (IKA) dhe anëtarëve të familjes së tij, i jepet mbulim shëndetësor në rast se i siguari ka realizuar 50 ditë pune gjatë vitit paraardhës. Pajisja e djalit të subjektit me këtë libër të shëndetit të

¹ Shihni përgjigjen e pyetjes 3 në pyetëtorin nr. 2, datë 6.11.2018, në dosjen e Komisionit.

fëmijës është provë se bashkëshorti i subjektit ka qenë i siguruar, si dhe nga ky sigurim djali i tyre ka përfituar librin e shëndetit.

- c. Gjithashtu, nëpërmjet prapësimeve, por edhe në seancë dëgjimore, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se në periudhën përgjatë së cilës ajo dhe bashkëshorti i saj kanë punuar/emigruar në Greqi, ata kanë përdorur edhe dokumente të tjera udhëtimi, të cilat, për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar, nuk ishin në gjendje t'i paraqisnin, pasi nuk i dispononin. Gjatë kësaj periudhe ata kanë punuar me orare të zgjatura dhe nuk kanë pasur mundësi për të qenë të siguruar dhe punëdhënësit e tyre të paguanin kontributet për punët që kanë kryer.

Vlerësimi i pakicës

- viii. Në lidhje me sa më lart, referuar deklarimeve, përgjigjeve të pyetësorëve, shpjegimeve dhe dokumenteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, për sa i takon fitimit të shumës prej 3.5 milionë lekësh nga emigracioni, për të bërë më të qartë konkluzionin në lidhje me to, duhet të analizohen dhe vlerësohen disa aspekte, si më poshtë vijon:
 - a. *Nëse subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj e kanë pasur apo jo mundësinë, nga ana legjislativo - administrative, për të punuar me rregulla, duke u kryer edhe pagesat përkatëse për kontributet dhe tatimet – për punën e tyre në Greqi, në periudhën e pohuar.*
 - b. *Nëse mjaftojnë shpjegimet, argumentimet dhe provat e paraqitura nga subjekti, për t'i konsideruar të ligjshme të ardhurat prej 3.5 milionë lekësh, me burim nga emigracioni.*
 - c. *Nëse mund të zbatohet në këtë rast pika 2 e nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, për pamundësinë objektive të subjektit që të paraqesë më shumë prova, për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar nga faktet.*

Duke u nisur nga pika e fundit, dhe së bashku me të, duke analizuar edhe dy pikat e tjera, nëpërmjet një gërshetimi dhe vlerësimi dispozitave ligjore në harmoni me faktet dhe rrethanat e njohura përgjatë hetimit administrativ në fjalë, arsyetohet se:

- ix. Ligji nr. 84/2016, në pikën 2, të nenit 32, parashikon mundësinë e çdo subjekti që: *“... nëse është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë – t'i vërtetojë institucionit të rivlerësimit shkaqet e pamundësisë...”*
- x. Në rastin konkret, edhe pse subjekti është përpjekur të provojë çfarë dhe sa ka mundur, dokumentacioni prej saj i prodhuar, dhe ai i munguar, për pamundësi objektive, ka pasur si objektiv direkt provueshmërinë e lejeve dhe të lehtësimeve të lëvizjeve drejt Greqisë, si dhe mundësinë e qëndrimit dhe të punësimit atje, por jo në mënyrë direkte provueshmërinë e burimeve financiare të ligjshme që bashkëshortët Panajoti kanë fituar në emigracion. Madje, nga subjekti, nuk janë dhënë as shifra mbi fitimet e pretenduara si të realizuara në vitet specifike apo në periudhat sezonale përkatëse për secilin prej tyre, por vetëm është paraqitur një përlllogaritje totale në rreth 3.5 milionë lekësh.
- xi. Për rrjedhojë, referuar pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, nga Komisioni mund të konsiderohet pamundësia e paraqitjes së të gjitha dokumenteve të udhëtimit, të përdorura në vitet '90, por jo pamundësia për të provuar një fakt që nuk ekziston: *“... dokumentacioni*

lidhur me burimin e ligjshëm, sipas nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, i të ardhurave të përfituara nga puna në emigracion...”

- xii. Mungesa e pagimit të tatimeve dhe kontributeve për periudhën që kanë punuar në Greqi, është pohuar e deklaruar në mënyrë të përsëritur nga vetë subjekti, e cila ka specifikuar se puna e kryer prej saj dhe bashkëshortit nuk ka qenë e zyrtarizuar dhe nuk janë paguar sigurimet shoqërore, dhe për rrjedhojë, as tatimet.
- xiii. Për rrjedhojë, nuk jemi përballë një pamundësie për të provuar një fakt që realisht ka ndodhur (siç mund të ishte pagesa e kontributeve dhe tatimeve për punën e kryer në Greqi) dhe që subjekti mund të legjitimohej për të paraqitur dokumente për pamundësinë e pasqyrimin të dokumentuar të ekzistencës dhe të vërtetësisë së tij (faktit). Por, bëhet fjalë për pamundësinë e provueshmërisë së periudhave të sakta të qëndrimit në Greqi, të kohëzgjatjes dhe të periudhave konkrete të punësimit atje.
- xiv. Gjithsesi, edhe nëse sa më lart do të mund të provohej, apo fakte do të konsideroheshin si të provuara, për shkak edhe në bazë të pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, përsëri këto të ardhura do të mbeteshin jo të ligjshme, në këndvështrimin e parashikimeve kushtetuese, ligjore dhe të orientimit jurisprudencial, të konfirmuar dhe të konsoliduar nga disa vendime të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (si p.sh: vendimet nr. 3, datë 17.7.2018; nr. 4, datë 25.10.2018; nr. 6 datë 13.9.2018; nr. 9 datë 24.10.2018).
- xv. Pikërisht, lidhur me këtë pikë, veç të tjerash, Kolegji i Posaçëm i Apelimit, në mënyrë të përsëritur është shprehur se: *“... me qëllim që remitancat të vlerësohen në gjykimet pranë Kolegjit, nevojitet që ato të provohen se janë dërgesa vlerash monetare të emigrantëve shqiptarë në vendin e origjinës, të cilat janë realizuar nga burime të ligjshme dhe për të cilat janë përmbushur detyrimet përkatëse tatimore në vendin e krijimit ...”*
- xvi. Gjithashtu, duhet të theksohet fakti që, nëse bashkëshortët Panajoti, do të kishin punuar të regjistruar dhe të zyrtarizuar/formalizuar, për punën që ata kanë kryer në Greqi, rrjedhimisht, në përmbushje të detyrimeve ligjore, do të ishin paguar nga punëdhënësit edhe kontributet për sigurimet shoqërore, dhe këto të fundit do të rezultonin ende edhe sot në të dhënat dhe arkivat e institucioneve shtetërore përkatëse, dhe për këtë arsye do të ishte e mundur që këto dokumente/vërtetime, nëpërmjet subjektit, të paraqiteshin edhe në Komision – pasi ato ruhen së paku deri në moshën e daljes në pension të individit kontribuues.
- xvii. Pra, edhe në bazë të arsyetimit të mësipërm, arrihet në konkluzionin se nuk ekziston një pamundësi për të provuar punësimin e rregullt dhe tatimet apo kontributet e paguara për punën e bashkëshortëve Panajoti, por nuk ekziston pagesa e tyre pasi, nuk është kryer, për sa kohë është punuar në *të zezë*.
- xviii. Përveç sa më lart, duhet evidentuar fakti që mundësia konkrete për të punuar me rregulla dhe me kontribute të paguara, nga këndvështrimi legjislativ dhe administrativ, ka qenë e realizueshme dhe në dispozicion të familjes Panajoti, pasi siç është dokumentuar nga vetë subjekti, prej vitit 1995, bashkëshorti i saj ka qenë i regjistruar në një zyrë pune që autorizonte pagesën e kontributeve dhe tatimeve për punën që ai do të kryente².

² “Çertifikatë e regjistrimit të një personi të siguruar drejtpërdrejtë”, të lëshuar nga institucioni përgjegjës për punësimin në Greqi, nga e cila rezulton se z. S. P. është deklaruar si i punësuar që në datën 16.10.1995 dhe po kështu, njoftohen punëdhënësit e tij për të dhënat e personit të siguruar si dhe për detyrimin për ta siguruar z. S. P.

- xix. Po ashtu, nga subjekti është pohuar se bashkëshorti i saj posedonte lejeqëndrimi në Greqi si dhe kishte marrë kombësi greke. Gjithashtu, është paraqitur si provë edhe një librezë shëndetësore e vitit 1995, e hapur për fëmijën e tyre³.
- xx. Për sa më lart, qartësohet dhe konfirmohet se nga ana legislative dhe procedurale ekzistonte mundësia për t'u punësuar me rregulla duke përfituar të gjitha benefitet e ligjit – përfshirë këtu edhe pagesën e sigurimeve shoqërore dhe tatimet fiskale. Kjo rrethanë bie ndesh dhe hedh poshtë qëndrimin e subjektit se – sipas tij – ata nuk mundeshin që të punonin me rregulla, nga momenti që nuk ekzistonte një legjislacion për emigracionin në Greqi, i krijuar shumë më pas, në vitin 2012. Vlerësohet se, edhe nëse ka pasur mangësi apo probleme të legjislacionit grek, sigurisht ky fakt nuk e ka cunuar mundësinë e punësimit me rregulla, me pagesën e kontributeve dhe të tatimeve për z. S. P., së paku nga viti 1995 e në vijim.
- xxi. Për më tepër, subjekti i rivlerësimit, nuk ka arritur të provojë disponimin e shumave të fituara nëpërmjet depozitave apo llogarive bankare në territorin grek – edhe pse qëndrimi i tyre atje ishte legal, gjë që e mundësonte hapjen e llogarive bankare – dhe as transferimin e këtyre të ardhurave në Shqipëri. Nga ana tjetër duhet thënë që, as depozitimi i të hollave në bankat në Greqi, dhe as spostimi i tyre nëpërmjet transfertave bankare drejt Shqipërisë, nuk ishte një detyrim – dhe kjo nuk mund të penalizojë subjektin – por nëse do të ekzistonin këto prova, së paku do të arrihej të qartësohej se cilat shuma monetare do të mund të ishin fituar në periudha të caktuara kohore gjatë emigracionit, pasi rezulton se këto të ardhura, sipas pretendimeve të subjektit, të gjitha me burim nga emigracioni, janë futur në sistemin bankar në Shqipëri, shumë vite më pas.
- xxii. Gjithashtu, dokumentimi i rrethanave të mësipërme do të hidhte dritë edhe mbi paqartësinë, nëse do të ishte e mundur që në dy vite të plota emigrim dhe në periudhën sezonale të disa viteve të tjera – gjithmonë sipas subjektit – të gjenerohej një fitim i tillë, që pasi të zbriteshin edhe kostot e jetesës në Greqi, si dhe të udhëtimeve të kryera, të mund të tepronte një kursim prej 3.5 milionë lekësh.
- xxiii. Për sa më lart, lidhur me këtë pikë, çmohet se në rastin konkret nuk plotësohen kushtet dhe rrethanat e kërkuara për të mundësuar aplikimin e pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, për sa i përket pamundësisë së pretenduar nga subjekti për të provuar burimin e ligjshëm të shumës prej 3.5 milionë lekësh, të krijuar në emigracion.

Në këto kushte, në vlerësim të pakicës, shpjegimet e dhëna nga subjekti mbeten të paprovuara me dokumente ligjore, lidhur me burimin e ligjshëm të shumës prej 3.500.000 lekësh – pasi ato janë pretenduar si të përfituara nga punësimi në emigracion, por kanë mbetur në nivel deklarativ dhe të paprovuara në kuptimin e nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

A.1.2 Lidhur me burimin nga aktiviteti tregtar i bashkëshortit të subjektit, në vitet 1995 – 1996, nëpërmjet shoqërisë “**” sh.p.k., ka dakordësi me sa ka shprehur edhe shumica, që këto të ardhura nuk janë provuar nga subjekti, apo nga hetimi i kryer.**

³ Subjekti ka depozituar gjithashtu edhe “Libër shëndeti fëmije” për djalin e saj, O. P., i datëlindjes 10.6.1995, lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë Greqi.

A.1.3 Gjithashtu, pajtohem me konkluzionet e shumicës se duhet konsideruar si burim i ligjshëm e ardhura nga shpronësimi i pasurisë së subjektit për interes publik, në shumën prej 720.000 lekësh, për një sipërfaqe toke 180 m².

A.1.4 Lidhur me të ardhurat nga punësimi i bashkëshortëve përgjatë periudhës 1995 – 2001, duhet specifikuar se të ardhurat *neto* të subjektit të rivlerësimit kanë qenë në vlerën 1.394.412 lekë, dhe ato të bashkëshortit të saj kanë rezultuar në vlerën 2.697.256 lekë, siç janë pasqyruar edhe në tabelën përshkruese të rezultateve financiare, të paraqitur në vendimin më lart, në paragrafin përkatës. Të ardhurat nga vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, në shumën 126.554 lekë, si dhe 150.000 lekë të ardhura nga shoqëria piramidale “Vefa”, nuk rezultojnë të jenë të provuara me dokumente ligjore, as fakti i përfitimit, dhe as specifikimi sasior dhe kohor i përfitimit të tyre. Gjithsesi, duke pasur parasysh peshën specifike të këtyre shumave në raport me mungesën e burimit të ligjshëm të konstatuar, këto burime të deklaruara nga subjekti në deklaratën “Vetting”, nuk do ta ndryshonin konkluzionin e pakicës mbi rivlerësimin e pasurisë së subjektit.

Për sa më lart, nga momenti që nuk është provuar burimi i ligjshëm për shumën prej 3.5 milionë lekësh, si të ardhura nga emigracioni, nga analiza financiare e periudhës 1995 – 2001 rezulton se subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën prej 3.820.219 lekësh – të përdorura për blerjen e apartamentit në janar të vitit 2002, për pasojë, në këtë rast, duhet të aplikohet pika 3, e nenit 61, e ligjit nr. 84/2016.

A.2 Lidhur me shumën prej 12.000 euro, të depozituar në llogari bankare nga subjekti në shkurt të vitit 2007

- i. Pakica bie dakord me parashtrimin dhe konkludimin e bërë nga shumica – në pikën 12 të vendimit pararendës – lidhur me mungesën e burimit financiar, në shumën prej 870.873 lekësh, për t’i mundësuar subjektit disponimin dhe depozitim të shumës prej 12.000 euro në shkurt të vitit 2007, por nuk pajtohet me qëndrimin përfundimtar të shumicës se kjo mangësi nuk ka mjaftueshëm peshë në vlerësimin e përgjithshëm të kriterit të pasurisë për të arritur në një masë, pasi duke e parë këtë gjetje së bashku me mungesën e konstatuar për blerjen e pasurisë në vitin 2002, gjendemi përballë një vlere negative të konsiderueshme ($3.820.219 + 870.873 = 4.691.092$ lekë), që sipas mendimit të pakicës çon në aplikimin e pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.
- ii. Fakti që subjekti i rivlerësimit ka pohuar se nuk i ka deklaruar kursimet *cash* në fund të vitit 2006, nuk e mundëson konsiderimin e këtyre shumave hipotetike *cash* si burim të depozitimit në fjalë, pasi ky fakt nuk është i provuar edhe pse ka ekzistuar mundësia e kursimit të kësaj shume. Lidhur me detyrimin e subjektit të rivlerësimit për deklarimin e gjendjes *cash* në banesë, të disponuar në çdo fundviti, do të argumentohet në vijim.

A.3 Gjendje *cash* jashtë institucioneve bankare e deklaruar në deklaratën “Vetting”, në vlerën 5.500 euro

- i. Edhe në lidhje me këtë pikë – të trajtuar në paragrafin nr. 11, në vendimin e mësipërm – pakica është dakord me parashtrimin e fakteve të bërë nga shumica, lidhur me shumën 2.000 euro, si pjesë përbërëse e gjendjes *cash* prej 5.500 eurosh, të deklaruar nga subjekti

në deklaratën “Vetting”, por nuk ndan të njëjtin mendim mbi konkluzionin e arritur nga shumica se: *deklarimi i subjektit në vitin 2015 ka qenë korrekt.*

- ii. Pika që e diferencon vlerësimin e pakicës qëndron në faktin se shuma prej 2.000 eurosh, në vitin 2015 konsiderohet e deklaruar vetëm si një burim financiar, me prejardhje nga shitja e automjetit – siç janë deklaruar edhe të ardhurat e tjera në atë vit, apo edhe në vitet e mëparshme – duke iu referuar veprimet juridik në datën e shitjes. Por, kjo shumë nuk është deklaruar në rubrikën përkatëse me përshkrimin si gjendje *cash*, pra, si shumë e disponuar jashtë sistemit bankar, në datën 31.12.2015.
- iii. Nga sa më lart, çmohet se edhe nëse do të merret i mirëqenë versioni i fakteve të paraqitura nga subjekti – sikurse edhe në pikën e mësipërme A.2 – alternativa e mungesës së burimit të ligjshëm financiar, si më lart (në këtë rast për të arritur në shumën *cash* prej 5.500 eurosh), do të ishte mosdeklarimi i gjendjes *cash*, edhe pse shitja e mjetit është deklaruar saktë, pasi nuk është e provuar që shuma e përfituar nga kjo shitje të mos jetë shpenzuar brenda atij viti, dhe për rrjedhojë, të jetë mbartur në disponim të subjektit në vitin pasardhës, kur i është shtuar edhe shuma *cash* prej 3.500 eurosh. Vetëm kjo shumë e fundit rezulton të jetë e deklaruar si gjendje *cash* në mënyrë të saktë, në vitin 2016.

B. Lidhur me mosdeklarimin e shumave monetare të disponuara në gjendje *cash*

- i. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e saj me shkrim, si dhe gjatë seancës dëgjimore, ka pohuar se nuk i ka deklaruar shumat e mbajtura *cash* në banesë dhe/ose ndryshimet e tyre, duke e argumentuar këtë qëndrim me faktin se, sipas saj, nuk ka ekzistuar ky detyrim ligjor për subjektet e deklarimit deri në vitin 2014, pasi vetëm me ndryshimet ligjore të atij viti ishte parashikuar detyrimi i deklarimit të shumave monetare të mbajtura jashtë sistemit bankar.
- ii. Pakica vlerëson se arsyetimi i subjektit nuk qëndron dhe se për rrjedhojë ajo ka paraqitur deklarime të pamjaftueshme ndër vite, nga momenti që në to ka munguar njëri nga komponentët që subjekti kishte detyrimin që ta deklaronte, pikërisht gjendja *cash* në banesë në çdo fundvit.
- iii. Gjithashtu, në vlerësimin e pakicës, siç është argumentuar edhe më sipër, në pikën A.3, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk e ka kryer deklarimin e gjendjes *cash* në vlerën 2.000 euro, as në vitin 2015, edhe pse – së paku për këtë vit (pas vitit 2014) edhe sipas interpretimit ligjor të subjektit – ekzistonte detyrimi i deklarimit të shumave jashtë sistemit bankar.
- iv. Detyrimi i deklarimit të disponimit të gjendjes monetare *cash* jashtë sistemit bankar ka lindur prej vitit 2003, nëpërmjet ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 "*Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë*", i botuar në Fletoren Zyrtare nr. 31, Maj 2003, në të cilin përcaktohet shprehimisht objekti i deklarimit nga subjektet deklaruese në ILDKPKI⁴, dhe konkretisht:
 - a. Në nenin 4 "*Afati dhe objekti i deklarimit*", parashikohet detyrimi i subjekteve për të deklaruar brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të pasurive, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare: "*d) vlerën e likuiditeteve, **gjendje në cash**, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj*".

⁴ Ky institucion (ILDKPKI), me shkresën nr. *** prot., datë 16.4.2018, qartëson dhe konfirmon ekzistencën e detyrimit të subjekteve deklaruese për të deklaruar shumat në gjendje *cash*, jashtë sistemit bankar, prej vitit 2003.

- b. Kuptimi i termit “*likuiditete*”, përkufizohet në pikën 2, të nenit 2, po të ligjit nr. 9049/2003, që saktëson: “*‘Likuiditete’ janë mjetet monetare, të vendosura në cash, llogari rrjedhëse, depozita, me dhe pa afat, bono thesari, obligacione dhe huadhënie*”.
- v. Nga analiza e dispozitës ligjore të sipërcituar, del qartë se midis zërave të detyrueshëm për t’u deklaruar është edhe “*gjendje cash*” i cili nuk mund të konsiderohet i përfshirë në shumatat e depozituara në llogaritë bankare, pasi është i ndryshëm dhe i shkëputur nga elementët e tjerë financiarë të përmendur aty, dhe për rrjedhojë përbën një detyrim autonom deklarimi, i cili nuk është përmbushur nga subjekti i rivlerësimit.
- vi. Për një qartësim më të plotë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, se vetëm me ndryshimet ligjore të vitit 2014 ka lidhur detyrimin për të deklaruar gjendjen *cash*, në vijim po kryejmë një analizë të shkurtër të ndryshimeve në fjalë.
- vii. Ligji nr. 45/ 2014, “*Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003*”, në nenin 2, përcakton ndryshimet e nenit 4, të këtij të fundit si më poshtë:
- a. Neni 2.2 *Shkronja d) ndryshohet si më poshtë: d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në cash jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj.*
- b. Pas nenit 4 shtohet neni 4/1 që përcakton shprehimisht, shumën *cash* jashtë sistemit bankar, me këtë përmbajtje: “*Për të gjithë zyrtarët, të cilët për shkak të funksionit publik që kryejnë, bëhen subjekte të këtij ligji dhe plotësojnë deklarin për herë të parë, sipas nenit 5/1, të tij, nuk mund të mbajnë dhe të deklarojnë gjendje në cash jashtë sistemit bankar, mbi shumën 1,5 (një presje pesë) milionë lekë*”.
- viii. Nga sa më lart, rezulton se risia e ndryshimeve ligjore në analizë qëndron në futjen e një limiti maksimal, (tavani në 1.5 milionë lekë), për mbajtjen e shumave monetare *cash* jashtë sistemit bankar. Pra, ky ndryshim nuk krijon një detyrim deklarimi *ex novo*, por thjesht saktëson në terma sasiorë detyrimin e mëparshëm, duke e kufizuar disponimin dhe, rrjedhimisht, edhe deklarin e gjendjes *cash* brenda shumës prej 1.5 milionë lekësh, ndërkohë që përpara këtij ndryshimi mund të deklaroheshin gjendje *cash* edhe në shuma më të larta⁵.
- ix. Së fundmi, lidhur me ndryshimin/plotësimin terminologjik të nenit 2.2, germa “*d*” të ligjit nr. 9049/2003, nga “*gjendje cash*” në “*gjendje në cash jashtë sistemit bankar*” rithekskohet se nuk bëhet fjalë për ndonjë ndryshim rrënjësor, në kuptimin e heqjes apo futjes së një zëri të ri për t’u deklaruar. Në fakt, kemi të bëjmë me një ndryshim leksik, që për më tepër është një plotësim i togfjalëshit “*gjendje cash*”, i cili, edhe pa shtojcën “*jashtë sistemit bankar*”, e ka luajtur rolin e tij për të përfaqësuar dhe përcaktuar një nga zërat e disponibiliteteve financiare për t’u deklaruar.
- x. Përpos pohimeve dhe argumentimeve të vetë subjektit, lidhur me mosdeklarimin e gjendjes *cash*, përgjatë hetimit administrativ, janë konstatuar disa vite, që së paku, në to duhej që të ishte deklaruar gjendja *cash* ose ndryshimi i saj, dhe konkretisht: në vitin 2006, kur subjekti deklaroi se shuma prej 12.000 eurosh, e depozituar në bankë në 23.2.2007, kishte qenë në gjendjen *cash* në banesë prej vitit 2003 – kur ishte shitur pasuria në Korçë; në vitin 2007 ndryshimin e gjendjes *cash* të përdorur për blerjen e apartamentit; në vitin 2015 gjendjen *cash* 2.000 euro, me burim shitjen e autoveturës.

⁵ Konkretisht, ky fakt ka ndodhur pasi shumë subjekte, në vitet përpara këtij ndryshimi ligjor, kanë deklaruar si gjendje *cash*, shuma më të larta se 1.5 milionë lekë.

Në konkluzion të kësaj pikë, pakica çmon se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime të pamjaftueshme që pasjellin aplikimin e pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, për sa kohë nuk ka përshkruar, në deklarimet vjetore të pasurisë, disponimin e gjendjeve *cash* dhe ndryshimeve të tyre ndër vite, duke mos e përmbushur këtë detyrim ligjor, përkatësisht nga viti 2003 deri në vitin 2016 – kur ka kryer deklarimin e parë të gjendjes *cash*.

C. Deklarime të pasakta dhe kontradiktore dhe/ose nënshkrimi i një kontrate fiktive

C.1 Lidhur me deklarimin e shumës prej 1.775.200 lekësh, në deklaratën “Vetting”, si të përfituar nga shitja e truallit me sipërfaqe 634 m², në Korçë

- i. Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën “Vetting”, në faqen 6 ku përshkruan të ardhurat, në pikën 3, deklaroi si burim financiar shumën prej **1.775.200 lekësh**, si të përfituar nga shitja e një trualli me sipërfaqe 634 m², në Korçë.
- ii. Nga kontrata e shitjes për një kohë të ardhme, e datës 17.5.2003, me nr. *** – rezultoi se objekti i saj ishte shitja e tre pronësive së bashku (me sip. totale **2.262 m²**), tek z. F. L., kundrejt një çmimi tërësor prej **1.900.000 lekësh** – dhe konkretisht, për blerjen e pasurive: nr. ***, me sip. 814 m², tokë; nr. ***, po me sip. 814 m², tokë; si dhe pronësia që i përkiste subjektit të rivlerësimit me nr. ***, **me sip. 634 m², tokë**.
- iii. Gjithashtu, nga përmbajtja e kontratës në fjalë – të cilën e ka nënshkruar si palë shitëse edhe subjekti i rivlerësimit – por edhe nga deklarimet e këtij të fundit, ka rezultuar se efektet e veprimit juridik të dakordësuar kanë qenë të menjëhershme, pasi palët deklarorinë se çmimi i shitblerjes është paguar dhe numëruar përpara noterit V. M., si dhe, palët shitëse, pasi e kanë marrë shumën e përcaktuar si çmim, i kalojnë blerësit të gjitha të drejtat mbi sendin duke ia dorëzuar atë të lirë dhe pa barrë.
- iv. Gjithashtu, ka rezultuar edhe një tjetër kontratë shitblerjeje – e datës 11.3.2004, me nr. ***, të nënshkruar përpara të njëjtit noter, V. M. (në Korçë) – e cila ka të njëjtin objekt, të njëjtin çmim dhe të njëjtat palë, por kjo nuk është nënshkruar nga subjekti, pasi për të ka nënshkruar një përfaqësues i saj, për të cilin ishte lëshuar një prokurë e rregullt.
- v. Duke analizuar dhe përlllogaritur çmimin total të kontratës në fjalë, në raport me çdo sipërfaqe që përbënte objektin e saj, ka rezultuar se pjesa takuese e subjektit të rivlerësimit, nga të ardhurat/çmimi që korrespondon me pronësinë e saj të shitur me sip. 634 m², është në vlerën **533.000 lekë** (634 m² x 840⁶ lekë/ m²), dhe jo **1.775.200 lekë**, sa e ka deklaruar subjekti në deklaratën “Vetting”.
- vi. Lidhur me këtë mospërputhje, subjekti ka shpjeguar se, **çmimi i shitjes ka qenë më i lartë se ai i pasqyruar në kontratë, pasi ka qenë një fiktivitet për të evituar pagesën e taksave dhe mbi këtë rrethanë ka paraqitur edhe deklaratat noteriale**. Pra, sipas saj, pretendohet se subjekti, në cilësinë e shitësit, ka përfituar të ardhura më të larta nga sa janë pasqyruar/specifikuar në kontratë, por kjo rrethanë bie ndesh me vetë përmbajtjen e kontratës në fjalë. Dhe gjithsesi, kontrata fiktive, nuk mund ta legjitimojë shumën e përfituar, përtej asaj për të cilën janë paguar detyrimet tatimore.
- vii. Gjithashtu, në bazë të ligjit, “Për tatimin mbi të ardhurat” subjekti, në rastin konkret, në cilësinë e shitësit, do të duhej të kishte paguar detyrimet tatimore për të gjithë shumën që

⁶ Përlllogaritur nga vlera 1.900.000 lekë/2.262 m² = 840 lekë/m².

pretendon se ka fituar nga shitja në fjalë – në përputhje me dispozitat ligjore të përcaktuara në atë periudhë. Duke qenë se kjo nuk ka ndodhur, subjekti nëpërmjet nënshkrimit të një kontrate më një çmim më të ulët se sa ai real, ka pranuar, ndihmuar dhe mundësuar shmangien e pagesës së plotë të detyrimeve tatimeve, mbi shumën e përfituar nga shitja në fjalë.

- viii. Arsyetimi i subjektit se ajo nuk ishte në dijeni të çmimit të pasqyruar në aktin noterial, pasi kontrata përfundimtare nuk ishte nënshkruar prej saj, nuk qëndron, për dy arsye:
- a. Nga njëra anë, duhet theksuar se ka qenë pikërisht në kontratën e datës 17.5.2003, e nënshkruar nga subjekti, që është caktuar çmimi e shitblerjes, i cili nuk ka ndryshuar më pas, por është konfirmuar edhe nga kontrata e dytë e datës 11.3.2004.
 - b. Nga ana tjetër, siç është pohuar edhe nga vetë subjekti, kontrata e parë i ka prodhuar të gjitha efektet juridike (dhe çmimi është përfituar nga subjekti më 17.5.2003 dhe është përlllogaritur në analizën e vitit 2003), ndërsa, kontrata e datës 11.3.2004, ka qenë thjesht një formalitet për të mundësuar regjistrimin e pronës në emër të blerësit, në të cilën, gjithsesi, është përsëritur dhe më pas ekzekutuar i njëjti vullnet i palëve, i shprehur në kontratën e mëparshme.

C.2 Lidhur me deklaratimet e subjektit mbi përdorimin e burimit financiar të përfituar nga shitja e pasurisë së paluajtshme në Korçë

- i. Të ardhurat nga shitja e truallit me sip. 634 m² – përpos faktit që në deklaratën “Vetting” janë deklaruar më të larta se ato që i përkisnin subjektit, sipas pjesës takuese dhe të dhënave të kontratës së shitblerjes në fjalë, siç është shpjeguar më sipër – subjekti i rivlerësimit i ka përshkruar ato si burim për krijimin e disa pasurive të ndryshme, dhe konkretisht:
 - a. në deklaratën “Vetting” janë deklaruar si burim për blerjen e pasurisë/apartament, në vitin 2007 (pasuria nr. 2);
 - b. në deklaratën e vitit 2003, janë deklaruar si burim për blerjen e pasurisë/apartament, në vitin 2002 (pasuria nr. 1);
 - c. në deklaratën e vitit 2003, si edhe në pyetësorin nr. 2 (përgjigja nr. 4), janë deklaruar si burim për krijimin e depozitës prej 20.000 USD, në bankë.
- ii. Përpos pamundësisë që të ardhurat nga shitja e kësaj pasurie të përdoshin për blerjen e pasurisë nr. 1 – për faktin se shitja e truallit është kryer në vitin 2003, pra, më pas se blerja apartamentit, që është realizuar në vitin 2002. Lidhur me këtë burim, nga analiza e fakteve ka rezultuar se:
 - a. nga viti 2003 dhe deri në momentin e blerjes së pasurisë nr. 2 (2.10.2007), subjekti nuk ka deklaruar kursime *cash* në banesë;
 - b. gjendja e llogarive bankare në datën 31.12.2006 rezulton të ketë qenë 834.136 lekë – pra, shumën në fjalë nuk mund të gjendej si likuiditet në depozita apo llogari bankare.

Faktet dhe rrethanat e përshkruara më lart (lidhur me pikën “C”) pasqyrojnë ekzistencën e një konfuzioni kontradiktor midis deklaratimeve të subjektit, mbi saktësinë sasiore të shumave të përfituara nga shitja e truallit në Korçë, si dhe mbi destinimin apo përdorimin e tyre për të krijuar pasuri të tjera.

Në vlerësimin tërësor të çështjes: mbështetur në provat, faktet dhe rrethanat që Komisioni disponon për kriterin e vlerësimit të pasurisë, si dhe në vlerësimin tërësor të procedurave për këtë

kriter, unë, si anëtar në pakicë/kundër, arrij në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur nivel të besueshëm në rivlerësimin e pasurisë dhe ka bërë deklarime të pamjaftueshme në lidhje me kriterin e pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Unë, si anëtar në pakicë, vlerësoj se vendimi i shumicës së trupit gjykues, që ka konfirmuar në detyrë subjektin e rivlerësimit, znj. Regleta Panajoti, nuk është i drejtë, pasi nuk i ka përmbushur të tria kushtet e pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, por vetëm dy prej tyre (“b” dhe “c”), duke munguar, sipas pakicës, plotësimin e kushtit të parashikuar në germën “a” të po kësaj pike.

Për arsyet e sipërcituara, sipas parashikimeve të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, si dhe pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, në lidhje me kriterin e pasurisë, bazuar në provat që disponon Komisioni dhe në deklaratimet e bëra në seancën dëgjimore, subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për vlerësimin e pasurisë dhe, për rrjedhojë, krijoj bindjen se shumica nuk duhet të kishte disponuar konfirmimin në detyrë të këtij subjekti, por shkarkimin e saj nga detyra.

Lulzim Hamitaj

Anëtar në pakicë/kundër